



**UNIVERSITETI I EJK
JHE YHIBEP3HTET
SEE UNIVERSITY**

STUDIMET PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

TEZA:

Masat për sigurimin e pranis së të pandehurit në procedurë penale me theks të veçante masën e paraburgimit në gjykatën themelore në Gjakovë

KANDIDATI:

Lekë Muqaj

MENTORI:

Prof.Dr. Besa Arifi

Tetovë, 2020

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	
4	

METODOLOGJIA E PËRDORUR	
5	

KREU I: VËSHTRIMI HISTORIKO-JURIDIK I MASAVE PËR SIGURIMIN E TË PANDEHURIT NË PROCEDURË PENALE

1.1 Pak histori mbi masat e sigurimit	
7	
1.2 Kuptimi i masave të sigurimit, sipas legjislacionit të RKS-së.	8
1.3 Kuptimi i të drejtës së lirisë dhe sigurisë sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut	13

KREU II: MASAT E SIGURIMIT PERSONAL

2.1 Nocioni dhe kuptimi i masave të sigurimit personal	15
2.2 Masat e sigurimit persona në RKS.....	17
2.2.1 Thirrja	17
2.2.2 Urdhërarresti	18
2.2.3 Premtimi i të pandehurit që nuk do ta braktis vendqëndrimin	19
2.2.4 Paraqitja në stacionin policorë.....	21
2.2.5 Dorëzania.....	21
2.2.5.1 Aktvendimi mbi dorëzanimë.....	22
2.2.5.2 Përmbajtja e dorëzanimë.....	23
2.2.5.3 Heqja e dorëzanimë.....	23
2.2.6 Arresti shtëpiak	24
2.2.7 Diversioni	25
2.2.8 Paraburgimi	26
2.2.8.1 Kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit.....	27
2.2.8.2 Procedura për urdhrin për paraburgim/ Caktimi i paraburgimit.....	28

2.2.8.3 Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e paraburgimit dhe ankesa kundër tij.....	
28	
2.2.8.4 Afatet kohore të paraburgimit.....	
29	
2.2.8.5 Vazhdimi i paraburgimit.....	30
2.2.8.6 Mbikëqyrja e paraburgimit nga gjykata.....	30
2.2.8.7 Caktimi i paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës.....	31

2.3 Problematikat e masës së paraburgimit në gjykatat e Kosovës	
32	

2.3.1 Vonesa e kallximeve penale nga policia si faktorë në dështimin e rasteve ne procedure paraprake	34
---	----

2.3.2 Dështimi i arsyetimeve të vendimeve për caktimin e masës se paraburgimit, si nga prokuroria po ashtu edhe nga gjyqtaret e procedurës paraprake	36
--	----

2.3.3 Stërzgjatja e paraburgimeve ne pritje te gjykimit të të akuzuarve dhe shqyrtimit te dyte, si kriteret ligjore për analizimin e masës se paraburgimit	40
--	----

2.3.4 Mos respektimi i afateve ligjore për caktimin e shqyrtimit fillestare	43
---	----

KREU III: ANALIZË KRAHASUESE TË MASAVE TË SIGURIMIT SIPAS LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS DHE ATI TË MAQEDONISË

3.1 Ngjashmëritë dhe dallimet e masave të sigurimit në RKS-së dhe RMV-së	44
--	----

3.2 Kushtet e përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit	48
---	----

3.3 Kushtet për caktimin e paraburgimit si masë më e rëndë për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale	49
--	----

3.3.1 Rreziku i ikjes	50
-----------------------------	----

3.3.2 Asgjësimi i provave	51
---------------------------------	----

3.3.3 Pesha dhe mënyra e kryerjes së veprës penale	52
--	----

KREU IV: INSTITUCIONET QË LUAJNË ROL NË CAKTIMINE MASAVE TE SIGURIMIT

4.1 Roli i Prokurorisë në caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit	52
---	----

4.2 Roli i Gjykatës në caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit	53
---	-----------

4.3 Roli i Policisë në caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit	54
---	-----------

KREU V: KONKLUSIONE DHE PËRFUNDIME

7.1 Konkluzione dhe përfundime	56
---	-----------

BIBLIGRAFIA	59
--------------------------	-----------

PARATHËNIE

Republika e Kosovës ka ndërmarrë një sërë reformash me qëllimin e vetëm për të forcuar ekzistencën dhe funksionimin e shtetit të së drejtës. Në këtë rrugë të gjatë e plotë sfida për tu realizuar, pa dyshim që një ndër promotorët kryesorë të tij ka qenë harmonizimi i legjislacionit vendore me atë ndërkombëtarë dhe të gjithë elementët përbërëse të saj. Kjo pasi e drejta është ajo që i paraprin, disiplinon dhe normon marrëdhëniet e ndryshme juridiko-shoqërore. Në mënyrë të pandërprerë është përmirësuar kuadri ligjor në veçanti ai penal, këto ndryshime janë imponuar nga nevoja e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Kjo teze fokus të veçantë do të ketë masat për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale, konkretisht masën e paraburgimit si masën më të ashpër në të drejtën pozitive në Republikën e Kosovës e cila cenon drejtpërdrejt lirit themelore të njeriut. Gjithashtu do të trajtojë probleme të tjera të vëzhguara gjatë hulumtimit si probleme kyçe gjatë zhvillimit të procedurës paraprake. Më konkretisht, hulumtimi do të përmbajë analiza të hollësishme me rekomandime konkrete për tema si: vonesa e kallximeve penale nga policia si faktorë në dështimin e rasteve në procedure paraprake, dështimi i arsytimit të vendimeve për caktimin e masës së paraburgimit, si nga prokuroria po ashtu edhe nga gjyqtaret e procedurës

paraprake, stërzgjatja e paraburgimeve në pritje të gjykimit të të akuzuarve dhe shqyrtimit të dytë, si kritere ligjore për analizimin e masës së paraburgimit dhe mos respektimi i afateve ligjore për caktimin e shqyrtimit fillestar.

Masat për sigurinë e të pandehurit në një proces Penale është një procedurë mjaft komplekse dhe problematike e cila është e lidhur ngushtë me lirinë personale. Liria personale nuk mund të kufizohet, veçse në raste dhe mënyrat e parashikuara nga ligji dhe me akt të arsyetuar nga autoriteti gjyqësor. Kodi i Procedurës Penale i RKS-së dallon disa lloje të masave për të siguruar prezencën e të pandehurit në procedurë, një ndër to është paraburgimi, i cila dallon nga masat e tjera si njëra ndër masat më shtrënguese në mënyrën e kufizimit të lirisë.

Duke marrë parasysh faktin se e drejta e lirisë dhe sigurisë së personit është një nga të drejtat më themelore dhe më të qenësishme të të drejtave të njeriut dhe vjen kurdoherë pas të drejtës së jetës dhe po ashtu duke marrë parasysh fenomenin e caktimit të shpeshtë të kësaj mase duke i “harruar” masat e tjera që parasheh Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, duke dashur që sado pak të ndikoj në koherencën e sistemit të drejtësisë që të mos abuzohet më këtë masë procedural kaq të ndjeshme që prek drejtpërdrejt në lirinë themelore të individit të garantuar më konventa ndërkombëtare dhe me aktin më të lartë shtetërorë, Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në fund, hulumtimi do të ofrojë edhe rekomandime konkrete për institucionet e përfshira në punën e gjyqësorit në Kosovë.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në këtë punim do të përdoruri një metodologji disi komplekse e ndërthurur kjo me disa elemente. Gjerësisht në këtë punim do të përdori rastet studimore, nga praktika e gjykatave të Kosovës apo juridiksioni i tyre. Nëpërmjet metodës analizuese dhe asaj induktive, do të bëjë një analizë të këtyre vendimeve, me qëllimin e nxjerrjes në pah të problematikave që mbartin ligjet në lidhje me masat e sigurimit dhe absolutisht nevojën për të bërë reforma drejt përsosjen së tyre.

Metoda Statistikore – Kjo metodë do të shfrytëzohet për të përcaktuar të dhënat statistikore vjetore nga Gjykata Themelore e Gjakovës për periudhën 2014-2018, të cilat të dhëna do të pasqyrojnë numrin vjetor të caktimit të masave në përgjithësi dhe masës së paraburgimit në veçanti.

Metoda Krahasuese – Do të shfrytëzohet për krahasimin e llojeve të masave të sigurimit dhe kritereve që përdoren për caktimin e tyre në RKS dhe me Ligjin për Procedurën Penal të Maqedonisë Veriore.

Kjo metodologji e përdorur më ka ndihmuar për të nxjerrë në pah karakteristikat, veçoritë dhe problematikat që mbartin masat e sigurimit në një procedim penal.

KREU I: VËSHTRIMI HISTORIKO-JURIDIK I MASAVE PËR SIGURIMIN E TË PANDEHURIT NË PROCEDURË PENALE

1.1 Pak histori mbi masat e sigurimit

Çdo e drejtë qoftë materiale apo procedurale, formohet dhe zhvillohet në përputhje me kushtet dhe rrethanat historike konkrete të zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore.

Vështrimi i zhvillimit historik të procedurës penale si tërësi tregon se ajo rrjedh prej veprës penale dhe procesit të kuptuar si çështje private të palëve, deri të vepra penale dhe procesi i kuptuar si çështje e rregullimit juridik, dhe se kjo ka pasur për pasojë organizimin e ndauardurshëm të procedurës penale. Kështu zhvillimi historik i deritanishëm ka hedhur në dritë tre sisteme apo tipa themelore të procedurës si; tipi akuzatorë (paditës), tipi inkvizitor (hetues) dhe tipi miks akuzator-inkvizitor.¹

Procedura akuzatore penale, si forma më e vjetër e procedurës penale, përsosmërinë e saj e fiton në Greqi dhe Romën e vjetër.

¹ Prof. Dr. Ejup Sahiti, Prof. Dr. Ismail Zejneli, E drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Tetovë 2007, fq. 15;

Në këtë tip të procedurës funksionin e mbrojtjes e ushtronte i pandehuri vet ose me mbrojtësin e tij. Pozita e të pandehurit në këtë tip të procedurës penale ishte e favorshme, ai ishte i obliguar të lëshohej në procedurë, nëse nuk i përgjigjej thirrjes sjellej me forcë.²

Megjithatë, në këtë periudhë kohore ende nuk mund të flitet për masat e sigurimit, ndonëse edhe në atë kohë ishte paraparë sjellja me forcë e të pandehurit si rezultat i shmangies nga procedura.

Si pikënisje fillestare për kodifikimin e disa garancive të procesit të rregullt përgjithësisht konsiderohet MAGNA CARTA e vitit 1215. Kapitulli 29, i versionit të vitit 1279 konfirmuar nga mbreti Eduard, në formën përfundimtare thotë: *“Asnjë njeri i lirë nuk mund të burgoset apo të zhvishet nga liritë e tij apo nga zakonet e lira, apo të nxirret jashtë ligjit, përveçse nëpërmjet gjykit të ligjshëm të të parëve të tij apo ligjit të vendit. Ne nuk do t’i shesim, t’i mohojmë apo t’i vonojmë askujt të drejtat dhe drejtësinë”*.

Pra, çdo person në çdo gjendje apo situatë duhet të gëzojë mbrojtje qoftë ky dhe autor i akteve kriminale.

Ndonëse çdo herë diskutohet përse duhet të ju kushtojmë kaq vëmendje mbrojtjes të autorëve të këtyre akteve kriminale, në vend që më shumë vëmendje të i kushtojmë viktimës? Kjo duhet të konsiderohet si mbrojtje për të gjithë qytetarët, të cilët mund të akuzohen për kryerjen e një krimi. Ata mbrohen mjaft mirë nga parimi i prezumimit të pafajësisë.³ Në bazë të këtij parimi, kushdo konsiderohet i pafajshëm përderisa në ngarkim të tij nuk është pranuar fajësia me vendim gjykate të formës së prerë, si dhe nga pikat e nenit 29 të Kushtetutës.

1.2 Kuptimi i masave të sigurimit, sipas legjislacionit të RKS-së

E drejta e lirisë dhe sigurisë së personit është një nga të drejtat më themelore dhe më të qenësishme të të drejtave të njeriut dhe vjen kurdoherë pas të drejtës së jetës, liria e personit nënkupton lirinë nga arrestimi dhe ndalimi ndërsa siguria e personit nënkupton mbrojtjen kundër ndërhyrjes arbitrare ndaj lirisë së tij.

Rastet e kufizimit të lirive të personit përbëjnë rezerva kushtetuese. Formulimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës është krejt i ngjashëm me atë që është sanksionuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Qëllimi i garancive kushtetuese për të drejtat dhe liritë themelore është mbrojtja e dinjitetit të njeriut, lirisë dhe barazisë. Këto janë vlera

² Prof. Dr. Ejup Sahiti, Prof. Dr. Ismail Zejneli, E drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Tetovë 2007, fq. 17;

³ Shih neni 29 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

themelore që karakterizojnë një shoqëri të drejtë, të hapur dhe demokratike dhe një bashkësi politike e cila mbështetet në sundimin e së drejtës.⁴

Kushtetuta u jep mundësi për t'u mbrojtur personave që akuzohen për kryerjen e një veprë penale, për aq kohë sa ata nuk janë deklaruar fajtorë për veprën e kryer, nga gjykata kompetente. Nëse personi dënohet pa u provuar akuzat që janë ngritur në ngarkim të tij, do të ndodheshim para një precedenti mjaft të rrezikshëm për shoqërinë. Kjo na bën të kuptojmë përse liritë personale marrin rëndësi kushtetuese.

Në bazë të nenit 21 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik të Republikës së Kosovës. Por ato nuk mund të përdoren për arritjen e qëllimeve kriminale ose në dëm të interesave të të tjerëve, prandaj mund të kufizohen me ligj, duke u mbështetur në nenin 55 paragraf 1 të Kushtetutës, ku shprehimisht thuhet: *“Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.”* Në këtë kuptim, ligji kryesor që përcakton dhe konkretizon mbrojtjen e të drejtave e të lirive dhe rregullat për kufizimin e tyre është Kodi i Procedurës Penale.

Në këtë drejtim mbrojtja juridiko penale e vlerave shoqërore dhe individuale kërkon që ndaj kryesit të veprës penale të merren edhe disa masa paraprake (të cilat në atë moment nuk konsiderohen si sanksione) gjersa është duke u zhvilluar procedura penale, me të cilat kufizohet liria apo mbrojtja e tij, ose atij i bëhet e pa mundur që ti shmangët procedurës penale, duke u arratisur ose ta pengoj zhvillimin e saj, duke i prishur gjurmët e veprës penale apo duke ndikuar në dëshmitarë, bashkekzekutor etj. Meqenëse procedura penale vihet në lëvizje dhe zhvillohet ndaj kryerësit të veprës penale – të pandehurit, përgjegjësia e të cilit tek duhet të vërtetohet në procedurë penale, zbatimi me konsekuencë i kësaj tendence nuk e përjashton mundësinë që të merren masa paraprake apo t'i kufizohet liria edhe qytetarit të pafajshëm.⁵

Në bazë të dispozitave të KPPRK-së, masat e tilla janë të natyrës së ndryshme dhe pikë së pari kanë të bëjnë më thirrjen e subjekteve procedurale, mirëpo ndaj disa subjekteve mund të ndërmerren edhe masa të tjera deri te kufizimi i lirisë.⁶ Një përkufizim tjetër

⁴ Prof. Dr. Enver Hasani, Prof. Dr. Ivan Čukalović, Komentar- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 79;

⁵ Dr. Ejup Sahiti, Argumentimi në Procedurë Penale, Prishtinë 2006, fq. 7;

⁶ Prof.dr.sc Ejup Sahiti, prof.dr.sc Rexhep Murati, Mr. Xhevdet Elshani, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës- Komentar Botimi 1, Prishtinë 2014, fq. 461;

përcakton se masat e sigurimit janë veprime procedurale që heqin ose kufizojnë liritë dhe të drejtat e personit ndaj të cilit është duke u zhvilluar procedura penale. Ato kanë si qëllim të mundësojnë zhvillimin normal të procedurës penale, por edhe të parandaloj veprimtarinë e mëtejshme kriminale të atij që ka kryer një vepër penale, të pengoj shmangjen e tij nga procedura, përpjekjet që ai mund ti bëjë për të vënë në rrezik marrjen e provës ose vërtetësinë e saj, si dhe të garantoj shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale.⁷

Neni 29 i Kushtetutës “E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë”:

1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

- a) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;
- b) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjyqimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;
- c) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;
- d) për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;
- e) për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim.

2. Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjyqimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjyqimit.

⁷ Dr. Azem Hajdari, Procedura Penale - Komentar, Prishtinë 2010, fq. 251;

3. Çdokush që privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet.

4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.

5. Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.

6. Personi që vuan dënimin, ka të drejtë të ankohet për kushtet e privimit nga liria, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Liria e personit si një nga të drejtat më të rëndësishme garantohet nga Kushtetuta në nenin 29 të saj. Kjo dispozitë fillon me një ndalim ligjor që në pikën 1 të saj, dhe kjo jo pa qëllim por për të treguar se liria e personit nuk mund të cenohet me përjashtim të rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj dhe sipas një procedure po të parashikuar në ligj. Shpesh ndodh që në praktikë të ndeshemi me situata të tilla që të detyrojnë për ta kufizuar këtë të drejtë për një të mirë në interes të shoqërisë.

Në bazë të nenit 29 të Kushtetutës paragrafi 1, liria dhe siguria e personit mund të kufizohet por vetëm në ato raste që parashikohen shprehimisht. Ky paragraf numëron taksativisht rastet në të cilat liria personale e personit mund të kufizohet, dhe vetëm në këto raste të sipërcituara të drejtat dhe liritë themelore mund të cenohen dhe nuk janë absolute. Pushteti shtetëror duhet sa më pak të kufizojë lirinë natyrore të individëve dhe ajo mund të intervenojë vetëm atëherë kur është e nevojshme që të mbrohet liria tjetër e dikujt. Rastet e heqjes së lirisë, të parashikuara në nenin 29 të Kushtetutës, janë rregulluar me ligje të veçanta. Të gjitha këto raste të heqjes së lirisë, në kuptimin e gjerë, janë masa sigurimi që synojnë parandalimin dhe luftën efektive kundër kriminalitetit dhe rreziqeve të tjera që i kanosen shoqërisë.

.Në një kapitull të veçantë të Kodit të Procedurës Penale, që bën fjalë për masat e sigurimit,⁸ është zbërthyer dhe konkretizuar rasti që personit mund t'i hiqet liria *“për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme*

⁸ Shih neni 173 të KPPRK-së;

*konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj”.*⁹

Ky është rasti që lidhet drejtpërdrejt me procedimin penal dhe që ndeshet më shpesh në praktikën e subjekteve të këtij procedimi, si një masë sigurimi që sjell heqjen e lirisë dhe shërben për zhvillimin me sukses të luftës kundër kriminalitetit dhe sidomos kundër krimeve të rënda. Për rastin kur personi është dënuar *me burgim*, nga gjykata kompetente, në bazë të ligjit procedural, ekzekutimi i sanksionit penal fillon kur vendimi me të cilin është shqiptuar sanksioni penal e merr formën e prerë dhe nëse për ekzekutimin e tij nuk ka pengesa ligjore.¹⁰ Institucioni korrektues përkatës lëshon vërtetim me shkrim për pranimin e të paraburgosurit, në të cilin përveç tjerash shënohet, dita dhe ora e pranimit, emri dhe mbiemri i personit i cili e ka sjellë të paraburgosurin.¹¹

Heqja e lirisë për shkak të zbatimit të masave edukuese, bazohet në Kodin për të Mitur,¹² i cili përcakton se masat që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë: masat e diversitetit dhe masat edukative që mund të jepen nga gjykata ndaj personave të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që, për shkak të moshës, nuk kanë përgjegjësi penale.

Për personat e sëmurë *mendërisht*, që nuk kanë kryer vepra penale, por që paraqesin rrezik për shoqërinë, zbatohen dispozitat e ligjit, “Për shëndetin mendor”.¹³ Në bazë të nenit 20 të këtij ligji, subjekt i trajtimit të pavullnetshëm është personi, i cili shtrohet në mënyrë të pavullnetshme në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër ose pasi është shtruar në mënyrë të vullnetshme mbahet në mënyrë të pavullnetshme, sipas përcaktimit të Komisionit të mjekëve specialist. Rastet, për të cilat gjykohet se një person me çrregullime mendore duhet të trajtohet në mënyrë të pavullnetshme, janë kur pa trajtimin e pavullnetshëm personi rrezikon jetën, shëndetin ose sigurinë e vetes apo të tjerëve dhe se nuk ka në dispozicion masa me pak ndërhyrëse të ofrimit të kujdesit të duhur. Vendimi për trajtim të pavullnetshëm të një personi merret nga Komisioni i mjekëve specialist vetëm pasi të ketë kryer ekzaminimin e tij. Personi me çrregullime mendore, familjarët e tij të afërt ose

⁹ Shih neni 29 paragraf 1 pika 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

¹⁰ Ligji Nr. 04/L-149, për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.31, gusht 2013, neni 6;

¹¹ Po aty, neni 197 paragraf 2;

¹² Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë Për të Mitur, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17, tetor 2018, neni 12;

¹³ Shih ligji Nr. 05/L -025 “Për Shëndetin Mendor”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 33, nëntor 2015, Prishtinë;

kujdestari ligjor gëzojnë të drejtën të informohen për shkaqet e marrjes së këtij vendimi dhe për të drejtat që pacienti gëzon në këtë gjendje.

Mjeku në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, që vendos për trajtimin e pavullnetshëm, përshkruan në mënyrë të hollësishme në kartelën mjekësore të gjitha procedurat e ndjekura dhe siguron njoftimin e shefit të shërbimit për shtrimin e pavullnetshëm, brenda njëzet e katër (24) orëve.¹⁴ Në rast se pas rivlerësimit, shefi i shërbimit konstaton se ekzistojnë shkaqet që personi të mbahet në kushte trajtimi të pavullnetshëm, personi vazhdon të marrë trajtimin e pavullnetshëm në këtë shërbim. Pas këtij vendimi, brenda dyzet e tetë (48) orëve, udhëheqësi i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, referuar nga shefi i shërbimit, i drejtohet gjykatës themelore për të vlerësuar procedurën e kryer.¹⁵ Gjyqtari e shqyrton kërkesën e paraqitur nga udhëheqësi i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, për vlerësimin e trajtimit të pavullnetshëm, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga paraqitja e saj. Në çdo rast, kur nuk ekzistojnë më shkaqet për trajtim të pavullnetshëm, udhëheqësi i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, familjarët ose përfaqësuesi ligjor parashtrojnë në gjykatën kompetente kërkesën për revokimin e vendimit të gjykatës.

Për personat që janë përhapës të *sëmundjeve ngjitëse*, heqja e lirisë bëhet duke zbatuar rregullat e parashikuara në ligj.¹⁶ Në bazë të nenit 33 të këtij ligji, personat për të cilët vërtetohet ose dyshohet se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshimtë në sëmundje nga murtaja, variola dhe ethet hemorragjike virale futen në karantinë. Kohëzgjatja e mbajtjes së personave në karantinë varet nga periudha maksimale e inkubacionit të sëmundjes përkatëse. Ministria e Shëndetësisë me propozim të Institutit Kombëtarë të Shëndetit Publik merr vendim për futjen në karantinë të personave dhe zbatimin e aktvendimit për futjen në karantinë të personave e sigurojnë organet kompetente në nivel të vendit.

Gjithashtu në ligj,¹⁷ është përcaktuar kompetenca e Policisë Kufitare, në bazë të së cilës ajo “bënë mbikëqyrjen e kufirit me qëllim të parandalimit të kalimit ilegal të kufirit

¹⁴ Shih ligji Nr. 05/L-025 “Për Shëndetin Mendor”, neni 22 paragrafi 4;

¹⁵ Po aty, neni 23 paragrafi 4

¹⁶ Ligji Nr. 02/L-109 “Për Parandalimin dhe Luftimin E Sëmundjeve Ngjitëse”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Viti III Nr. 40, tetor 2008 Prishtinë;

¹⁷ Ligji Nr. 04/L-072 “Për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufijve Shtetëror”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.02, janar 2012 Prishtinë;

shtetëror, parandalimit të krimit tejkuftar dhe ndërmarrjes së masave kundër personave të cilët në mënyrë të paligjshme e kanë kaluar kufirin.”

Ligji parashikon se¹⁸ me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, të paraqitur nëpërmjet prokurorit, gjykata në bazë të nenit 21 të ligjit për “Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale” mund të caktojë masa në mënyrë që të sigurohet prania e personit të kërkuar gjatë procedurës së ekstradimit, Prokuroria dhe Gjykata Themelore veprojnë në përputhje me dispozitat e KPPRK-së. Edhe para pranimit të kërkesës për ekstradim, personi i kërkuar mund të arrestohet dhe paraburgoset për një periudhë maksimale prej dyzet (40) ditësh, në qoftë se shteti kërkuar dorëzon tek Ministria kërkesën për arrest të përkohshëm, dhe se një kërkesë për ekstradim do të paraqitet në kohën e duhur.

1.3 Kuptimi i të drejtës së lirisë dhe sigurisë sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Neni 5 “E drejta për liri dhe siguri”, i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut:

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

- a) Kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;
- b) Kur arrestohet ose burgoset ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;
- c) Kur është arrestuar dhe paraburgosur për t’u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;
- d) Kur një i mitur ndalohet ligjërisht, për qëllim edukimi të mbikëqyrur, ose për ndalimin e tij të ligjshëm, me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent gjyqësor;

¹⁸ Ligji NR. 04/L-213 “Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.33, shtator 2013 Prishtinë;

- e) Kur individët ndalohen ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;
- f) Kur një person arrestohet ose ndalohet ligjërisht, me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose për një person kundër të cilit është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi;

2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.

3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet nga garanci për t'u paraqitur para gjykatës.

4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.

5. Çdo person, që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, ka të drejtën e zbatueshme të dëmshpërblimit.

Parimi i lirisë dhe sigurisë në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, është sanksionuar në nenin 5 të saj. Ai parashikon të gjithë elementët e privimit të lirisë, duke filluar nga arrestimi fillestar, e deri tek lirimi. Ai definon të drejtën e lirisë, subjekt vetëm i disa përjashtimeve ligjore që lejojnë arrestimin në rrethana të caktuara, të tilla si arrestimi i personave të dyshuar për krim apo burgosjen e personave të dënuar nga gjykata. Gjithashtu ofron të drejtën për t'u informuar në gjuhën që ata kuptojnë, për arsyet e arrestimit dhe akuzave kundër tyre, të drejtën për paraqitje të menjëhershme në një gjykatë për të përcaktuar ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit, të drejtën e gjyimit brenda një afati të arsyeshëm ose

të liritë si pjesë e kohës së procedurës, dhe të drejtën për kompensim në rastet e arrestimit ose ndalimit në kundërshtim me këtë nen.

KREU II: MASAT E SIGURIMIT PERSONAL

2.1 Nocioni dhe kuptimi i masave të sigurimit personal

Duke qenë se disa veprime procedurale shërbejnë për vërtetimin e drejtpërdrejt të fakteve të rëndësishme përmes së cilave konstatohet gjendja faktike, ndërmarrja e disa veprimeve të tjera nuk ka qëllim vërtetimin e drejtpërdrejt të fakteve relevante, por krijimin e kushteve për vërtetimin e fakteve relevante.¹⁹ Në grupin e veprimeve procedurale të cilat hapin rrugën, apo krijojnë kushte për ndërmarrjen e veprimeve procedurale me të cilat vërtetohen faktet relevante, bëjnë pjesë masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale.

Në Republikën e Maqedonisë Veriore, masat i kategorizojnë në dy grupe; ato për sigurimin e prezencës së personave si parakusht për zhvillim të suksesshëm të procedurës penale (masat e drejtuara të pandehurit apo ndonjë pjesëmarrësi procedural tjetër) dhe masat për sigurimin e gjësëndeve të nevojshme për zhvillim të suksesshëm të procedurës penale.²⁰

Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit, pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe sigurimin e suksesshëm të zhvillimit të procedurës penale, në esencë janë masa që hapin rrugë për ndërmarrje të veprimeve procedurale nga organet e ndjekjes, respektivisht, Prokuroria dhe Policia përmes të cilave vërtetohen fakte relevante të rëndësishme për realizimin e qëllimit përfundimtar të procedurës penale. Masat në fjalë nuk janë sanksione penale, ato duhet kuptuar si veprime procedurale që shërbejnë për të siguruar një proces të rregullt penal. Këto masa, në fakt, janë veprime procedurale që heqin ose kufizojnë liritë dhe të drejtat e personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale.²¹ Qëllimi i tyre i drejtpërdrejt është që të mundësojnë zhvillimin normal të procedurës penale duke siguruar prezencën e të pandehuri në çdo fazë të procedurës si kriter kryesorë, të parandaloj veprimet e më tejshme kriminale siç është përfundimi i veprës penale nëse nuk është kryer apo kryerja e ndonjë

¹⁹ Prof. Dr. Ejup Sahiti, Prof. Dr. Rexhep Murati, Mr. Xhevdet Elshani, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës- Komentar Botimi 1, Prishtinë 2014, fq. 461;

²⁰ Prof. Dr. Ejup Sahiti, Prof. Dr. Ismail Zejneli, E drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq. 131;

²¹ Prof. Dr. Azem Hajdari, Procedura Penale – Komentar, Prishtinë 2010, fq.251;

vepre tjetër të re penale si dhe evitim të rrezikut për shmangjen apo asgjësimin e provave materiale apo ndikimin tek dëshmitarët.

Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale janë të llojllojshme dhe mund të zbatohen në të gjitha fazat e procedurës penale. Sipas nenit 173 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, ekzistojnë këto masa: thirrja, urdhërarrestimi, premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitja në stacionin policor, dorëzania, arresti shtëpiak, diversioni dhe paraburgimi.

Gjykata, me rastin e vendosjes se cilën nga këto masa do ta zbatoj në një rast konkret, ajo, duhet të ketë parasysh kushtet e përcaktuara ligjore për masat konkrete dhe të sigurohet që të mos zbatohet masa më e rëndë kur mjafton masa më e butë në mënyrë që të mos cenohen liritë themelore të njeriut të garantuara me konventa ndërkombëtare. Duke qenë se liria e personit nënkupton lirinë nga arrestimi dhe ndalimi ndërsa siguria e personit nënkupton mbrojtjen kundër ndërhyrjes arbitrare ndaj lirisë së tij, profesorët Ejup Sahiti dhe Ismail Zejneli në librin e tyre “ E Drejta e Procedurës Penale në Republikën e Maqedonisë” jo rastësisht përmendin faktin se Gjykata, me rastin e vendosjes se cilën nga masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit do ta zbatojnë në një rast konkret për të siguruar praninë e të pandehurit, udhëhiqet me parimin e ligjshmërisë, të gradualitetit të proporcionalitetit dhe të kontrollit gjyqësor *ex officio* të zbatimit të tyre.

Këto masa hiqen kur pushojnë shkaqet që i kanë shkaktuar, apo zëvendësohen me masa të tjera më të buta po qe se për këtë plotësohen kushtet. Para ngritjes së aktakuzës vendimet lidhur me këto masa i merr gjyqtari i procedurës paraprake, kurse pas ngritjes së aktakuzës vendimet i merr kryetari i trupit gjykues.²²

2.2 Masat e sigurimit persona në RKS

Neni 173 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

1. Masat të cilat mund të përdoren për të siguruar praninë e të pandehurit, për pengimin e rikrërjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale janë:

²² Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit, neni 173, fq. 78;

- 1.1. thirrja;
- 1.2. urdhërarresti;
- 1.3. premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin;
- 1.4. ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar;
- 1.5. paraqitja në stacionin policor;
- 1.6. dorëzania;
- 1.7. arresti shtëpiak
- 1.8. diversioni; dhe
- 1.9. paraburgimi.

2.2.1 Thirrja

Me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, thirrja është paraparë si formë themelore nëpërmjet të cilës realizohet prania e të pandehurit në procedurë²³. Çështjet që ndërlidhen me thirrjen janë rregulluar me nenin 174 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Me këtë nen është përcaktuar autoriteti i cili e dërgon thirrjen të pandehurit, mënyrën e dorëzimit, përmbajtjen e saj, kohën dhe vendin, obligimin e të pandehurit për të njoftuar gjykatën për adresën, pasojat e mos paraqitjes sipas thirrjes.

Thirrjen të pandehurit ia dërgon gjykata në, thirrja i dërgohet në letër të mbyllur e cila përfshin: emrin dhe adresën e gjykatës e cila e dërgon thirrjen; emrin dhe mbiemrin e të pandehurit; përcaktimin e veprës penale për të cilën akuzohet; vendin, ditën dhe orën kur duhet të paraqitet i pandehuri, njoftimin se thirret në cilësi të të pandehurit; paralajmërimin se në rast të mosparaqitjes do të lëshohet urdhërarrest dhe do të sillet në gjykatë forcërisht; vulën zyrtare dhe emrin e gjyqtarit i cili lëshon thirrjen (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 174 të KPPRK-s).

Kur i pandehuri thirret për herë të parë, në thirrje udhëzohet për të drejtën e tij për të angazhuar mbrojtës dhe se mbrojtësi mund të jetë i pranishëm gjatë marrjes së tij në pyetje (paragrafi 3 i nenit 174 të KPPRK-s).

Në mënyrë që të mos haset në pengesa të komunikimit, i pandehuri duhet menjëherë ta njoftojë gjykatën për çdo ndryshim të adresës së tij ose për qëllimin e ndryshimit të vendqëndrimit. I pandehuri njoftohet për këtë detyrim në rastin e marrjes në pyetje për herë të

²³ Prof. Dr. Ejup Sahiti, Prof. Dr. Ismail Zejneli, E drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq. 132;

parë ose me rastin e dorëzimit të aktakuzës dhe njëkohësisht paralajmërohet për pasojat e mospërmbyshjes së këtij detyrimi (paragrafi 4 i nenit 174 të KPPRK-s).

Dhe në fund, kur i pandehuri nuk është në gjendje t'i përgjigjet thirrjes për shkak të sëmundjes ose pengesës tjetër të paevitueshme, ai pyetet në vendin ku gjendet ose dërgohet në ndërtesën e gjykatës apo në vendin tjetër ku është duke u zbatuar procedura ose shtyhet marrja e tij në pyetje deri në përmirsimin e gjendjes së tij apo rrethanave të cilat kanë qenë shkak për mosprezencë (paragrafi 5 i nenit 174 të KPPRK-s).

2.2.2 Urdherarresti

Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sipas detyrës zyrtare mund të lëshojë urdhërarrest me kërkesë të prokurorit të shtetit, ose në rrethana të ngutshme me kërkesë të policisë kur ekzistojnë kushtet nga paragrafi 1. i nenit 187 të këtij Kodi, ose kur i pandehuri i cili pasi është thirrur me rregull nuk paraqitet dhe nuk e arsyeton mungesën e tij ose kur thirrja nuk ka mundur t'i dërgohet sipas rregullit dhe kur sipas rrethanave është e qartë se i pandehuri i shmanget pranimin të thirrjes (paragrafi 1 i nenit 175 të KPPRK-s).

Urdhërarresti lëshohet me shkrim dhe përfshin: emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhëna të tjera personale të njohura për gjyqtarin, përcaktimin e veprës penale me të cilën ngarkohet duke iu referuar dispozitës përkatëse të Kodit Penal, bazën mbi të cilën lëshohet urdhri dhe vulën zyrtare dhe nënshkrimin e gjyqtarit që lëshon urdhërarrestin. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në urdhërarrest, urdhërarresti skadon në mesnatën e ditës së treqind e gjashtëdhjetë e pestë (365) të nga dita e lëshimit, urdhërarrestin e ekzekuton policia (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 175 të KPPRK-s).

Zyrtari i policisë i ngarkuar për ekzekutimin e urdhrit ia dorëzon urdhrin të pandehurit dhe kërkon që i pandehuri ta shoqërojë. Kur i pandehuri këtë e refuzon, atëherë dërgohet forcërisht (paragrafi 4 i nenit 175 të KPPRK-s).

Urdhri për paraqitje të detyrueshme të zyrtarëve të policisë ose të rojtarëve të institucionit ku personat mbahen në ndalim ekzekutohet nëpërmjet ndërmjetësimit të komandës ose eprorit të tyre (paragrafët 5 i nenit 175 të KPPRK-s).

Në kohën e arrestimit, personi informohet në gjuhën që e kupton për arsyet e arrestimit dhe për të drejtat nga neni 167 i këtij Kodi. Menjëherë pas arrestimit, personi i arrestuar dërgohet para gjyqtarit i cili e ka lëshuar urdhrin (paragrafët 6 dhe 7 të nenit 175 të KPPRK-s).

2.2.3 Premtimi i të pandehurit që nuk do ta braktis vendqëndrimin

Gjykata gjatë procedurës mund të kërkojë nga i pandehuri premtimin se nuk do të fshihet ose largohet nga vendqëndrimi pa lejen e gjykatës kur ekziston dyshim i bazuar se ai ka kryer veprë penale dhe ka arsye për dyshim se i pandehuri mund të fshihet, të shkojë në vend të panjohur ose të largohet nga Kosova. Premtimi i dhënë shënohet në procesverbal (paragrafi 1 i nenit 176 të KPPRK-s).

Dokumenti i udhëtimit të të pandehurit, i cili detyrohet me premtimin e dhënë nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të konfiskohet përkohësisht. Ankesa kundër aktvendimit për konfiskimin e dokumentit të udhëtimit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit (paragrafi 2 i nenit 176 të KPPRK-s).

Me rastin e dhënies së premtimit, i pandehuri paralajmërohet se ndaj tij mund të caktohet paraburgim po qe se e shkel këtë premtim (paragrafi 3 i nenit 176 të KPPRK-s).

2.2.4 Ndalimi për t'iu afruar vendit apo personit të caktuar

Gjykata mund t'ia ndalojë të pandehurit për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar kur: ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer veprë penale; ekzistojnë rrethanat nga neni 187, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2.2. *(kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit)* ose nën-paragrafi 1.2.3. *(kur peshja e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej)* të këtij Kodi; dhe ndalimi i tillë mund të zvogëlojë rrezikun që i pandehuri t'i asgjësojë provat e veprës penale,

të ndikojë në dëshmitarë, në bashkëkryerës ose në bashkëpjesëmarrës pas kryerjes së veprës, në përsëritjen e veprës penale, në përfundimin e veprës penale të tentuar ose në kryerjen e veprës penale për të cilën është kanosur (paragrafi 1 i nenit 177 të KPPRK-s).

Gjykata vendos për një masë sipas këtij neni me aktvendim të arsyetuar. Aktvendimi duhet të përmbajë arsyetimin që përcakton se janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni dhe nevojën për masën e tillë (paragrafi 2 i nenit 177 të KPPRK-s)

Gjykata me aktvendim përcakton largësinë përkatëse nga vendi i caktuar ose nga personi të cilën i pandehuri duhet ta respektojë dhe nuk duhet ta kalojë me qëllim (paragrafi 3 i nenit 177 të KPPRK-s).

Aktvendimi i dërgohet të pandehurit dhe ku është e zbatueshme një kopje i dërgohet personit të mbrojtur nën masën e tillë (paragrafi 4 i nenit 177 të KPPRK-s).

Gjykata urdhëron paraburgim nëse i pandehuri shkel aktvendimin. I pandehuri gjithmonë njoftohet me kohë për pasojat e mosbindjes (paragrafi 5 i nenit 177 të KPPRK-s).

Nëse personi i mbrojtur me këtë masë qëllimisht cenon distancën të cilën i pandehuri detyrohet ta respektojë, gjykata mund ta dënojë personin e mbrojtur me gjobë siç parashihet në nenin 444 të këtij Kodi (paragrafi 6 i nenit 177 të KPPRK-s).

Përveç kur ky nen parasheh ndryshe, dispozitat e këtij Kodi lidhur me paraburgimin përshtatshmërisht zbatohen për caktimin, kohëzgjatjen, vazhdimin dhe pushimin e masës nga ky nen (paragrafi 7 i nenit 177 të KPPRK-s).

Për zgjatjen e masës nga ky nen para ngritjes së aktakuzës vendos gjyqtari i procedurës paraprake sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të prokurorit të shtetit (paragrafi 8 i nenit 177 të KPPRK-s).

2.2.5 Paraqitja në stacionin policorë

Gjykata mund të urdhërojë që i pandehuri të paraqitet herë pas here në kohë të caktuar në stacionin policor, në rajonin ku i pandehuri e ka vendbanimin apo vendqëndrimin ose në vendin ku i pandehuri është ndodhur në momentin e urdhrit, nëse: ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale; dhe ka arsye për të dyshuar se i pandehuri do të fshihet,

do të shkojë në vend të panjohur ose do të largohet nga Kosova (paragrafi 1 i nenit 178 të KPPRK-s).

Gjykata vendos për një masë sipas këtij neni me aktvendim të arsyetuar. Aktvendimi duhet të përmbajë arsyetimin që përcakton se janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni dhe nevojën për masën e tillë (paragrafi 2 i nenit 178 të KPPRK-s).

Aktvendimi i dorëzohet të pandehurit dhe kopja i dorëzohet stacionit policor përkatës në territorin e së cilës masa duhet të zbatohet (paragrafi 3 i nenit 178 të KPPRK-s).

Gjykata mund të urdhërojë paraburgim nëse i pandehuri shkel aktvendimin. I pandehuri gjithmonë njoftohet me kohë për pasojat e mosbindjes (paragrafi 4 i nenit 178 të KPPRK-s).

Përveç kur ky nen parasheh ndryshe, dispozitat e këtij Kodi lidhur me paraburgimin përshtatshmërisht zbatohen për caktimin, kohëzgjatjen, vazhdimin dhe pushimin e masës nga ky nen (paragrafi 5 i nenit 178 të KPPRK-s).

Për zgjatjen e masës nga ky nen para ngritjes së aktakuzës vendos gjyqtari i procedurës paraprake sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të prokurorit të shtetit (paragrafi 6 i nenit 178 të KPPRK-s).

Dokumenti i udhëtimit i personit i cili i nënshtrohet aktvendimit sipas këtij neni mund të konfiskohet përkohësisht. Ankesa kundër aktvendimit për konfiskimin e përkohshëm të dokumentit të udhëtimit nuk e pezullon ekzekutimin (paragrafi 7 i nenit 178 të KPPRK-s).

2.2.5 Dorëzania

Gjykata mund të urdhërojë që i pandehuri të mbrohet në liri me dorëzani ose të lirohet nga paraburgimi me dorëzani kur: ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale; baza e vetme për paraburgim është frika se i pandehuri mund të ikë; dhe kur i pandehuri premtun se nuk do të fshihet ose pa leje nuk do të braktisë vendqëndrimin e tij (paragrafi 1 i nenit 179 të KPPRK-s).

Gjykata me aktvendim gjithashtu mund të urdhërojë që i pandehuri të mbrohet në liri me dorëzani ose të lirohet nga paraburgimi me dorëzani kur: ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale; i pandehuri nuk dyshohet për vepër penale të dënueshme me të paktën pesë (5) vjet burgim sipas kapitujve XIV, XV, XVI, XVII, XX, XXI, XXIX, XXX

dhe XXXIII të Kodit Penal; baza e vetme për paraburgim është rreziku se i pandehuri mund të përsërisë veprën penale, të përfundojë veprën e tentuar penale ose të kryejë veprën penale të cilën është kanosur ta kryejë; dhe i pandehuri ka premtuar se nuk do ta përsërisë veprën penale, nuk do ta përfundojë veprën e tentuar penale ose nuk do ta kryejë veprën penale të cilën është kanosur ta kryejë (paragrafi 2 i nenit 179 të KPPRK-s).

Dorëzania e urdhëruar nga gjykata jepet nga i pandehuri ose personi tjetër në emër të tij (paragrafi 3 i nenit 179 të KPPRK-s).

2.2.5.1 Aktvendimi mbi dorëzaninë

Gjykata me aktvendim të arsyetuar vendos mbi masën nga neni 179 i këtij Kodi. Aktvendimi duhet të përmbajë arsyetimin që përcakton se janë plotësuar kushtet nga neni 179 i këtij Kodi dhe nevojën për masën e tillë (paragrafi 1 i nenit 180 të KPPRK-s).

Para ngritjes së aktakuzës, aktvendimi mbi dorëzaninë merret nga gjyqtari i procedurës paraprake ndërsa pas ngritjes së aktakuzës nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues (paragrafi 2 i nenit 180 të KPPRK-s).

Aktvendimi me të cilin dorëzania pranohet dhe aktvendimi me të cilin ajo anulohet merren pas dëgjimit të mendimit të prokurorit të shtetit, nëse vepra penale ndiqet sipas detyrës zyrtare, dhe mendimit të të pandehurit ose mbrojtësit, aktvendimi i dorëzohet të pandehurit (paragrafi 3 dhe 4 i nenit 180 të KPPRK-s).

Personit që i nënshtrohet aktvendimit me dorëzani i konfiskohet përkohësisht dokumenti i udhëtimit, përveç nëse ka arsye bindëse për gjykatën që të mos konfiskojë dokumentin e udhëtimit. Ankesa ndaj aktvendimit për konfiskimin e përkohshëm të dokumentit të udhëtimit të personit nuk e pezullon ekzekutimin (paragrafi 5 i nenit 180 të KPPRK-s).

2.2.5.2 Përmbajtja e dorëzisë

Dorëzania gjithmonë përkufizohet si shumë e parave e përcaktuar sipas peshës së veprës penale, rrethanave personale dhe familjare të të pandehurit dhe gjendjes materiale të personit që e jep dorëzaninë (paragrafi 1 i nenit 181 të KPPRK-s).

Dorëzania mund të jepet me para të gatshme, me letra me vlerë, sende të vlefshme dhe me pasuri të tjera të luajtshme me vlerë të konsiderueshme të cilat lehtë mund të shndërrohen në para dhe të ruhen, me vënien e hipotekës për shumën e dorëzisë mbi vlerat e paluajtshme të personit që jep dorëzani ose me detyrim personal të një apo më shumë personave që në rast të ikjes së të pandehurit zotohen të paguajnë shumën e caktuar të dorëzisë (paragrafi 2 i nenit 181 të KPPRK-s).

Nëse i pandehuri ik, me aktvendim të gjykatës caktohet që vlera e dhënë si dorëzani të derdhet në fondin për kompenzimin e viktimave (paragrafi 3 i nenit 181 të KPPRK-s).

2.2.5.3 Heqja e dorëzisë

Kur urdhërohet dorëzani nga neni 179, paragrafi 1. i këtij Kodi, i pandehuri paraburgoset dhe dorëzania hiqet, nëse pas thirrjes me rregull ai nuk paraqitet dhe mungesën nuk e arsyeton, nëse përgatitet të ikë ose kur gjatë kohës sa është në liri paraqiten arsye të tjera ligjore për paraburgimin e tij (paragrafi 1 i nenit 182 të KPPRK-s).

Kur urdhërohet dorëzani nga neni 179, paragrafi 2. i këtij Kodi, i pandehuri paraburgoset dhe shuma e dhënë si dorëzani me aktvendim derdhet në buxhet, kur ai ka përsëritur veprën penale, ka përfunduar veprën e tentuar penale ose ka kryer veprën penale për të cilën ai është kanosur se do ta kryejë (paragrafi 2 i nenit 182 të KPPRK-s).

I pandehuri gjithmonë njoftohet me kohë për pasojat e mosbindjes (paragrafi 3 i nenit 182 të KPPRK-s).

Dorëzania hiqet kur procedura penale pushohet me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë. Kur i pandehuri dënohet me burgim, dorëzania hiqet vetëm pasi ai të ketë filluar mbajtjen e dënimit (paragrafi 4 i nenit 182 të KPPRK-s).

Me heqjen e dorëzarisë, paratë e gatshme të depozituara, letrat me vlerë, sendet me vlerë dhe pasuri të tjera të luajtshme me vlerë të konsiderueshme kthehen dhe hipoteka hiqet (paragrafi 5 i nenit 182 të KPPRK-s).

2.2.6 Arresti shtëpiak

Gjykata mund të caktojë arrestin shtëpiak për të pandehurin nëse: ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale; dhe plotësohen kushtet nga neni 187, paragrafi .1, nën-paragrafi 1.2. i këtij Kodi (paragrafi 1 i nenit 183 të KPPRK-s).

Gjykata me aktvendim të arsyetuar vendos mbi masën nga ky nen. Aktvendimi duhet të përmbajë arsyetimin që përcakton se janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni dhe nevojën për masën e tillë (paragrafi 2 i nenit 183 të KPPRK-s).

Gjykata me aktvendim vendos se i pandehuri nuk guxon të largohet nga lokalet ku ai e ka vendbanimin ose vendqëndrimin apo nga institucioni publik për trajtim ose përkujdesje. Gjykata mund ta kufizojë ose ndalojë kontaktin ndërmjet të pandehurit dhe personave me të cilët ai nuk jeton apo të cilët nuk janë të varur nga i pandehuri. Përfundimisht, gjykata mund të lejojë të pandehurit që për kohë të caktuar të largohet nga lokalet ku mbahet arresti shtëpiak kur kjo është domosdo e nevojshme për përmbushjen e nevojave jetësore ose për kryerjen e ndonjë pune (paragrafi 3 i nenit 183 të KPPRK-s).

Aktvendimi i dorëzohet të pandehurit dhe një kopje i dorëzohet stacionit policor përkatës në territorin në të cilin duhet të zbatohet masa (paragrafi 4 i nenit 183 të KPPRK-s).

Gjykata mund të caktojë paraburgim nëse i pandehuri pa leje shkel aktvendimin. I pandehuri për këto pasoja gjithmonë duhet njoftuar me kohë (paragrafi 5 i nenit 183 të KPPRK-s).

Gjykata e mbikëqyrë zbatimin e masës së arrestit shtëpiak drejtpërdrejt ose nëpërmjet policisë. Policia ka të drejtë që në çdo kohë të verifikojë zbatimin e masës së arrestit shtëpiak dhe rastësisht verifikon praninë e të pandehurit në vendin e mbajtjes së arrestit shtëpiak. Policia e njofton gjykatën pa vonesë për çdo cenim të mundshëm të masës (paragrafi 6 i nenit 183 të KPPRK-s).

Përveç nëse ky nen parasheh ndryshe, dispozitat e këtij Kodi mbi paraburgimin përshtatshmërisht zbatohen lidhur me caktimin, kohëzgjatjen, vazhdimin dhe pushimin e

masës nga ky nen. Dispozitat e Kodit Penal mbi përfshirjen e ndalimit në dënimin e shqiptuar gjithashtu zbatohen përshtatshmërisht për masën nga ky nen (paragrafi 7 i nenit 183 të KPPRK-s).

Pas ngritjes së aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos në të gjitha rastet mbi vazhdimin e arrestit shtëpiak në bazë të propozimit të arsyetuar të prokurorit të shtetit. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij, kur i pandehuri ka mbrojtës, duhet njoftuar për propozimin brenda tre ditëve nga kalimi i afatit të aktvendimit aktual mbi arrestin shtëpiak (paragrafi 8 i nenit 183 të KPPRK-s).

Personit në arrest shtëpiak përkohësisht mund t'i konfiskohet dokumenti i udhëtimit. Ankesa kundër aktvendimit mbi konfiskimin e përkohshëm të dokumentit të udhëtimit nuk e pezullon ekzekutimin (paragrafi 9 i nenit 183 të KPPRK-s).

2.2.7 Diversioni

I pandehuri i arrestuar për veprë penale për të cilën dënimi maksimal i paraparë është jo më shumë se një (1) vjet dhe i cili nuk ka dënime të mëparshme ose nuk ka marrë pjesë në diversion, mund t'i caktohet diversioni sipas urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake. I pandehuri ose prokurori i shtetit gjithashtu mund të propozojnë diversionin. Nëse prokurori i shtetit pajtohet ose i propozon gjykatës masën e diversionit, gjyqtari i procedurës paraprake mund të pezullojë procedurën penale për një (1) vit dhe liron të pandehurin nën kushtet e mëposhtme: 1.1. i pandehuri duhet të bëjë kompenzimin e arsyeshëm ndaj viktimës së veprës penale, nëse ka ndonjë, siç përcakton gjyqtari i procedurës paraprake; 1.2. i pandehuri lajmërohet rregullisht në stacionin policor që është më së afërmi prej vendbanimit të tij, në intervalet e caktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake; 1.3. i pandehuri merr pjesë dhe përfundon këshillimin, trajtimin psikologjik, trajtimin nga abuzimi me substanca narkotike, arsimimin, ose veprimet tjera të cilat konsiderohen të përshtatshme nga gjyqtari i procedurës paraprake (paragrafi 1 i nenit 184 të KPPRK-s).

Kur i pandehuri vepron në pajtim me kushtet e përcaktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake, procedura penale kundër të pandehurit pushohet nga gjyqtari i procedurës paraprake gjatë muajit të dymbëdhjetë të diversitetit (paragrafi 2 i nenit 184 të KPPRK-s).

Nëse i pandehuri shkel kushtet e përcaktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake, procedura penale rifillohet. Gjyqtari i procedurës paraprake, nëse është e nevojshme, mund të lëshojë urdhërarrest sipas nenit 175 të këtij Kodi (paragrafi 3 i nenit 184 të KPPRK-s).

2.2.8 Paraburgimi

Kodi Penal parasheh mundësinë e kufizimit të lirisë së të pandehurit dhe përcakton kushtet nën të cilat mund të caktohet paraburgimi. Duke qenë se është masa më e rëndë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale nga se me këtë bëhet kufizimi i lirisë së tij, është detyrë e të gjitha organeve që marrin pjesë në këtë procedurë të veprojnë me nguti të posaçme kur i pandehur ndodhet në paraburgim. Paraburgimi duhet të hiqet në cdo fazë të procedurës po sa të pushojnë shkaqet për caktimin e tij.²⁴

Paraburgimi mund të caktohet vetëm nën kushtet dhe në pajtim me procedurat e parapara me këtë Kod (paragrafi 1 i nenit 185 të KPPRK-s).

Paraburgimi duhet të reduktohet në kohën sa më të shkurtër të mundshme. Kur i pandehuri mbahet në paraburgim, të gjitha organet që marrin pjesë në procedurën penale dhe organet që ofrojnë ndihmën juridike detyrohen të veprojnë me nguti të posaçme (paragrafi 2 i nenit 185 të KPPRK-s).

Paraburgimi hiqet dhe i paraburgosuri lirohet në çdo fazë të procedurës posa të pushojnë shkaqet e caktimit të tij (paragrafi 3 i nenit 185 të KPPRK-s).

Neni 166, paragrafët 2 dhe 3 neni 167 paragrafi 2, neni 168, neni 169, neni 170, paragrafi 3 dhe neni 171, paragrafët 3 dhe 4 të këtij Kodi gjithashtu zbatohen gjatë kohës së paraburgimit (paragrafi 4 i nenit 185 të KPPRK-s).

Me rastin e arrestimit, personi që i nënshtrohet paraburgimit informohet: 5.1. gojarisht dhe me shkrim për të drejtat nga neni 167 i këtij Kodi; dhe 5.2. me shkrim për të drejtat tjera që i gëzon sipas këtij Kodi (paragrafi 5 i nenit 185 të KPPRK-s).

Kur është e nevojshme të ndërmerren masa për mbrojtjen e fëmijëve dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së personit të arrestuar të cilët janë nën kujdesin e tij, për arrestim njoftohet organi kompetent për mirëqenie sociale (neni 186 të KPPRK-s).

²⁴ Prof.dr.sc Ejup Sahiti; prof.dr.sc Rexhep Murati; Mr. E Drejta e Procedurës Penale; Prishtinë 2013, fq 198

2.2.8.1 Kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit

E drejta jonë e procedurës penale i përmbahet sistemit taksativ të përcaktimit të shkaqeve për paraburgim. Në këtë kuptim janë përcaktuar edhe kushtet sipas të cilave mund të paraburgoset një person në bazë të një vendimi të gjykatës (gjyqtari i procedurës parapenale). Është me rëndësi të theksohet se për caktimin e paraburgimit duhet të plotësohet një kusht themelorë, e ai është dyshimi i bazuar se personi ka kryer veprë penale. Pastaj domosdo duhet të vijë në konsideratë ndonjëri prej shkaqeve tjera që i parasheh neni 187 i Kodit të Procedurës Penale i Republikës së Kosovës.²⁵

Gjykata mund të caktojë paraburgim ndaj një personi vetëm nëse në mënyrë të qartë ka gjetur se:

- a) ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer veprë penale;
- b) përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:

- i. kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij; (paragrafi 1 i nenit 187 të KPPRK-s)
- ii. kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit (paragrafi 1 i nenit 187 të KPPRK-s); ose
- iii. kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej (paragrafi 1 i nenit 187 të KPPRK-s).

- c) masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit të parapara në nenin 173 të këtij Kodi do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë, të

²⁵ Prof.dr.sc Ejup Sahiti; prof.dr.sc Rexhep Murati; Mr. E Drejta e Procedurës Penale; Prishtinë 2013, fq 198

parandalojë përsëritjen e veprës penale dhe të sigurojë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale (paragrafi 1 i nenit 187 të KPPRK-s).

2.2.8.2 Procedura për urdhrin për paraburgim/ Caktimi i paraburgimit

Paraburgimin e cakton gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës kompetente në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit pas seancës dëgjimore. Pasi që personi i arrestuar të jetë sjellë te gjyqtari i procedurës paraprake, ai menjëherë e informon personin e tillë për të drejtat e tij të garantuara me këtë ligj. Në procesverbal shënohet koha e saktë e arrestimit dhe koha kur është sjellur personi te gjyqtari i procedurës paraprake (paragrafi 1 dhe 2 i nenit 188 të KPPRK-s).

Pastaj, gjyqtari i procedurës paraprake zbaton seancën dëgjimore mbi paraburgimin. Prokurori i shtetit dhe mbrojtësi janë të pranishëm gjatë seancës dëgjimore (paragrafi 3 i nenit 188 të KPPRK-s).

Kur personi i arrestuar nuk angazhon mbrojtës brenda njëzet e katër (24) orëve nga koha e njoftimit për këtë të drejtë ose deklaron se nuk do të angazhojë mbrojtës, gjykata ia cakton mbrojtësin sipas detyrës zyrtare (paragrafi 4 i nenit 188 të KPPRK-s).

Në seancën dëgjimore për paraburgim, prokurori i shtetit paraqet arsyet për kërkim të paraburgimit. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të përgjigjen duke prezantuar argumentet e tyre. Gjyqtari i procedurës paraprake vendos mbi propozimin e palëve pasi palët të jenë deklaruar për të gjitha çështjet të cilat mund të jenë të rëndësishme për zbatimin e masave nga ky kapitull (paragrafi 5 dhe 6 i nenit 188 të KPPRK-s).

2.2.8.3 Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e paraburgimit dhe ankesa kundër tij

Paraburgimi caktohet me aktvendimin me shkrim i cili përfshin: emrin dhe mbiemrin e personit i cili paraburgoset dhe të dhënat e tij personale të njohura për gjyqtarin e procedurës paraprake; kohën e saktë të arrestimit; kohën e sjelljes te gjyqtari i procedurës paraprake; kohën e marrjes në pyetje për paraburgim; veprën penale për të cilën akuzohet; bazën ligjore për paraburgim; njoftimin për të drejtën në ankesë; dhe arsyetimin e të gjitha fakteve vendimtare që e kanë shkaktuar paraburgimin, duke përfshirë edhe arsyet për dyshim të bazuar se personi ka kryer vepër penale dhe faktet vendimtare nga neni 187, paragrafi 1,

nën-paragrafi 1.2. i këtij Kodi. Aktvendimi mbi paraburgimin i dorëzohet personit përkatës, mbrojtësit të tij dhe prokurorit të shtetit. Koha e dorëzimit të aktvendimit personit përkatës shënohet në shkresat e lëndës (paragrafi 1 dhe 2 i nenit 189 të KPPRK-s).

Secila palë mund të paraqesë ankesë brenda njëzet e katër (24) orëve nga koha e dorëzimit të aktvendimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Nëse ankohet vetëm njëra palë, gjykata ia dërgon ankesën palës tjetër e cila argumentet e veta mund t'ia paraqesë gjykatës brenda njëzet e katër (24) orëve nga dorëzimi i ankesës. Për ankesë vendoset brenda dyzet e tetë (48) orëve nga paraqitja e saj. Kur gjyqtari i procedurës paraprake e refuzon kërkesën e prokurorit të shtetit për caktimin e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë cilëndo masë tjetër nga ky kapitull (paragrafi 3 dhe 4 i nenit 189 të KPPRK-s).

2.2.8.4 Afatet kohore të paraburgimit

I paraburgosuri mund të mbahet në paraburgim më së shumti një (1) muaj nga dita e arrestimit në bazë të urdhrit nga neni 188 të këtij Kodi. Pas kësaj kohe, ai mund të mbahet në paraburgim vetëm me aktvendim të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues me të cilin urdhërohet vazhdimi i paraburgimit (paragrafi 1 i nenit 190 të KPPRK-s).

Para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi nuk mund të zgjasë më shumë se: a) katër (4) muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me më pak se pesë (5) vjet burgim; dhe b) tetë (8) muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim. Në raste të jashtëzakonshme kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim dhe kur rasti është i ndërlikuar siç përkufizohet në nenin 19 të këtij Kodi, e zvarritja e procedurës nuk mund t'i atribuohet prokurorit të shtetit, para ngritjes së aktakuzës paraburgimi mund të vazhdohet më së shumti deri në katër (4) muaj për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej dymbëdhjetë (12) muaj (paragrafi 2 dhe 3 i nenit 190 të KPPRK-s).

Kur ka shkak të bazuar dhe bindës për të besuar se ekziston rrezik i përgjithshëm apo rrezik i dhunës nëse lirohet i pandehuri në procedurë paraprake, vazhdimi i paraburgimit nga paragrafi 3. të këtij neni mund të vazhdohet edhe për gjashtë (6) muaj tjerë për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej tetëmbëdhjetë (18) muaj. Nëse aktakuza nuk ngritet para

kalimit të afateve të parapara, i paraburgosuri lirohet (paragrafi 4 dhe 5 i nenit 190 të KPPRK-s).

2.2.8.5 Vazhdimi i paraburgimit

Paraburgimi mund të vazhdohet vetëm nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, i cili tregon se ka bazë për paraburgim në bazë të këtij Kodi, se ka filluar hetimi dhe se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme për të përshpejtuar zbatimin e hetimit. I dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave mund të kërkojë formalisht apo joformalisht nga prokurori i shtetit që të kërkojë vazhdimin e paraburgimit (paragrafi 1 i nenit 191 të KPPRK-s).

I pandehuri dhe mbrojtësi i tij informohen me propozimin jo më vonë se tri (3) ditë para skadimit të paraburgimit të caktuar me aktvendimin e fundit. Ndaj çdo aktvendimi mbi vazhdimin e paraburgimit mund të ushtrohet ankesë (paragrafi 2 dhe 3 i nenit 191 të KPPRK-s).

2.2.8.6 Mbikëqyrja e paraburgimit nga gjykata

Në çdo kohë, derisa hetimi është duke u zbatuar, gjyqtari i procedurës paraprake mund të ndërpreje paraburgimin sipas detyrës zyrtare, pasi të ketë paralajmëruar prokurorin e shtetit tre ditë më parë. Prokurori i shtetit mund të paraqesë ankesë te kolegji shqyrtues kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për të ndërprerë paraburgimin. Kolegji shqyrtues nxjerr aktvendim brenda dyzet e tetë (48) orësh nga pranimi i ankesës së prokurorit të shtetit (paragrafi 1 i nenit 192 të KPPRK-s). Sipas paragrafit 2 të këtij neni, i paraburgosuri ose mbrojtësi i tij në çdo kohë mund t'i ankohen gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose kryetarit të gjykatës themelore që të vendosë mbi ligjshmërinë e paraburgimit ose mbi ligjshmërinë e kushteve të paraburgimit.

Nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose kryetari i gjykatës themelore mund të zbatojë seancë dëgjimore në pajtim me neni 188, paragrafët 3., 4., 5. dhe 6. të këtij Kodi nëse në shikim të parë me ankesë vërtetohet se: 3.1. arsyet për paraburgim nga neni 187

i këtij Kodi që nga vendimi i fundit gjyqësor për paraburgim pushojnë së ekzistuari për shkak të ndryshimit të rrethanave ose zbulimit të fakteve të reja; ose 3.2. ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i kundërligjshëm, 4.1. pushojnë së ekzistuari arsyet e paraburgimit nga neni 187 i këtij Kodi; 4.2. ka kaluar afati i paraburgimit i urdhëruar nga gjykata; 4.3. afati i paraburgimit i caktuar nga gjykata kalon afatin e paraparë në nenin 190 të këtij Kodi (paragrafi 3 dhe 4 i nenit 192 të KPPRK-s).

Nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e kushteve të paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose kryetari i gjykatës themelore mund të zbatojë një seancë dëgjimore ose vizitë në institucionin ku mbahet paraburgimi nëse ankesa në shikim të parë vërteton se kushtet e paraburgimit nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë Kod ose nëse ekzistojnë kushte të cilat nuk janë në pajtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, siç interpretohet nga vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Të lartcekurit mund të urdhërojnë ndryshimin e kushteve të paraburgimit nëse kushtet nuk janë në pajtim me interpretimin e arsyeshëm të kushteve të përcaktuara me këtë Kod ose nëse ekzistojnë kushte të cilat nuk janë në pajtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore. Seancat dëgjimore ose vizitat nga ky nen mbahen brenda shtatë (7) ditëve nga pranimi i ankesës. (paragrafi 5, 6 dhe 7 i nenit 192 të KPPRK-s).

2.2.8.7 Caktimi i paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës

Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, paraburgimi mund të caktohet, vazhdohet ose të hiqet vetëm me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose trupit gjykues në seancë. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues së pari dëgjon mendimin e prokurorit të shtetit kur procedura është filluar me kërkesën e tij dhe mendimin e të pandehurit ose mbrojtësit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese (paragrafi 1 i nenit 193 të KPPRK-s).

Pasi të kalojnë dy (2) muaj nga aktvendimi i fundit për paraburgim, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues edhe pa propozimin e palëve shqyrton nëse ende ekzistojnë arsyet për paraburgim dhe merr aktvendim për vazhdimin ose heqjen e paraburgimit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese. Neni 189, paragrafët 3. dhe 4. të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht (paragrafi 2 i nenit 193 të KPPRK-s).

2.3 Problematikat e masës së paraburgimit në gjykatat e Kosovës

Fokus të veçantë kjo analizë ka pasur në rastet nga procedura paraprake, si dhe raste të shqyrtimit kryesor që kanë të bëjnë me persona të dyshuar të veprave penale të ndodhur në paraburgim. ngase kjo ka të bëjë drejtpërdrejt me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara edhe me konventa evropiane.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) i ka kushtuar rëndësi të veçantë masës së paraburgimit në mënyrë që organet e gjyqësisë t'i peshojnë si duhet dhe sa duhet arsyet në çdo rast ku mendojnë të caktojnë paraburgimin. Sipas KEDNJ-së: “Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”.²⁶ Edhe ligji vendor i zbatueshëm në Kosovë në mënyrë të ngjashme përcakton që “Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përpos rasteve dhe në pajtim me procedurën e përcaktuar me ligj”.²⁷ Në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës parashihen nëntë masa të cilat mund të përdoren për të siguruar praninë e të pandehurit, për pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale.²⁸ Me rastin e vendosjes se cila nga masat do të zbatohet për të siguruar praninë e të pandehurit, gjykata detyrohet t'i marrë parasysh kushtet e përcaktuara për masat konkrete dhe të sigurojë që të mos zbatojë masë më të rëndë kur mjafton masa më e butë. Masa e paraburgimit është e listuar si masa e fundit për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë, mirëpo në praktikë kjo masë në të shumtën e rasteve përdoret si masa e parë dhe e vetme.

Gjatë analizës është vërejtur se në disa raste prokurorët nuk kanë arritur të dëshmojnë dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale, ndërsa vetëm kanë parafrazuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale pa u ndërlidhur me rrethanat specifike të rastit dhe pa u thirrur në argumente konkrete që dëshmojnë se paraburgimi i të pandehurit është vërtetë i domosdoshëm.

Fatkeqësisht në praktikë, nga prokuroria janë të rralla rastet kur kërkohet aplikimi i ndonjë mase tjetër për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë. Pothuajse të gjitha kërkesat janë për caktimin e masës së paraburgimit. Në të shumtën e rasteve kur ka prova të mjaftueshme që i pandehuri ka mundur ta kryejë veprën penale, ku mund të aplikohet edhe

²⁶ Shih neni 6 par.2 i KEDNJ-së

²⁷ Shih neni 12 par.1 i KPPRK-së

²⁸ Shih neni 173 i KPPRK-së

masa e arrestit shtëpiak pasi që kjo masë llogaritet si dënim në përfundim kjo varet çdo herë nga kërkesa e prokurorit dhe pavarësisht të drejtës për barazi të palëve²⁹, gjykata megjithatë përparësi në të shumtën e rasteve u jep kërkesave të prokurorëve pa marrë parasysh arsyetimet e tyre.

*“Gjyqtarët thonë se prokurorët thirren vetëm në pikat e Kodit të Procedurës Penale, duke anashkaluar faktin që secili rast përmban karakteristikat e veçanta të cilat duhet të arsyetohen mirë. Në opinionet e tyre, gjyqtarët thonë se rrallëherë i refuzojnë propozimet e prokurorëve për caktimin e masës së paraburgimit edhe atëherë kur ato propozime nuk janë të arsyetuara mirë, gjë për të cilat barra më e rëndë u bie vet gjyqtarëve me rastin e arsyetimit të vendimit”.*³⁰

Nga ana tjetër, prokurorët ankohen në mungesën e azhuritit të policisë në raport me prokurorinë, për sa i përket afatit 24 orësh pas arrestimit të të dyshuarit për kryerje të veprës penale.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës parasheh që brenda njëzetekatër (24) orëve pas arrestimit të të dyshuarit, prokurori i shtetit t’i paraqesë gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën për caktimin e paraburgimit³¹. Prokurorët thonë se në praktikë shpesh ballafaqohen me problemin e mos-azhuritit të policisë ndaj personave të ndaluar nga prokurori, të cilët kallëzimet penale i dorëzojnë në prokurori vetëm pak para se të skadojë afati 24 orësh për paraqitjen e kërkesës në gjykatë dhe kallëzimet penale në të shumtën e rasteve sipas prokurorëve paraqiten me prova të zbehta.

*“Prokurorët thonë se ka raste të shpeshta kur policia dërgon kallëzime penale vetëm dy orë para skadimit të afatit 24 orësh, periudhë brenda së cilës prokurori është i obliguar që patjetër të paraqesë kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit te gjyqtari i procedurës paraprake. Kjo, sipas prokurorëve, ndikon në mos arsyetimin e duhur të propozimeve për caktimin e masës së paraburgimit, që në raste të caktuara thonë se gjykata refuzon kërkesat e prokurorit ose i hedh krejt si të pabazuara”.*³²

Gjatë hulumtimit të rasteve të paraburgimit, haset në parregullsi të shumta që kanë të bëjnë me vonesat e kallëzimeve penale nga policia në prokurori, me dështim të arsyetimeve të vendimeve për caktimin e masës së paraburgimit, si nga prokuroria ashtu edhe nga

²⁹ Sipas nenit 9 të KPPRK-së, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë.

³⁰ BIRN Kosova; Raporti i Monitorimit të Gjykatave; Prishtinë 2016, fq 10

³¹ Shih neni 164 par.7 i KPPRK-së

³² BIRN Kosova; Raporti i Monitorimit të Gjykatave; Prishtinë 2016, fq 11

gjyqtarët e procedurës paraprake, stërzgjatjen e paraburgimeve në pritje të gjykimit të të akuzuarve si dhe mos respektimi i afateve gjyqësore për caktimin e shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë. Për të gjitha pikat ka shembuj konkretë për të elaboruar këtë gjendjen.

2.3.1 Vonesa e kallximeve penale nga policia si faktorë në dështimin e rasteve në procedure paraprake

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, sapo policia të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, ajo është e detyruar që brenda njëzet e katër (24) orëve t'i dorëzojë një raport policor prokurorit të shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurën penale³³.

Po ashtu, Kodi i Procedurës Penale parasheh që brenda njëzetekatër (24) orëve pas arrestimit, prokurori i shtetit i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën për caktimin e paraburgimit³⁴.

Në mënyrë që prokurorët të hartojnë kërkesa të arsyetuara mirë për paraburgim, ata brenda kësaj periudhe prej 24 orëve duhet të pranojnë sa më shpejt kallëzimet penale të policisë të cilat duhet të jenë sa më të kompletuara në mënyrë që kërkesat e prokurorit për caktimin e masës për prezencën e të dyshuarit të jenë sa më të suksesshme.

Ankesat e prokurorëve sa i përket mos arsyetimit të mirë të kërkesave për caktimin e masës së paraburgimit qëndrojnë në vonesat e kallëzimeve penale të policisë. Ata, thonë se shpeshherë pranojnë kallëzime penale 22 apo 23 orë pas arrestimit të të dyshuarve, vetëm një apo dy orë para skadimit të afatit ligjor prej 24 orësh, të cilat madje thonë se shpeshherë nuk janë të kompletuara me prova përcjellëse dhe adekuate në kallëzimin penal. Afati i shkurtër për dorëzimin e kërkesave për caktimin e masës së paraburgimit thonë se ndikon drejtpërdrejt edhe në kualitetin e arsyetimeve në kërkesat e tyre, që në të shumtën e rasteve janë shabllone dhe të paarsyetuara si duhet.

Pos rasteve kur policia dorëzon kallëzime penale pak orë para skadimit të afatit, një problem tjetër edhe më i madh është kur dorëzimi i kallëzimit penal nga policia bëhet pas kalimit të afatit prej 24 orësh.

³³ Shih neni 70 par.4 i KPPRK-së

³⁴ Po aty neni 164 par.7

Në Gjakovë me datë 04.12.2015, i dyshuari është ndaluar për shkak të dyshimit se ka kryer dy vepra penale “Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare” nga neni 410 dhe vepra penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 273 i KPRKsë. Për shkak të dorëzimit me vonesë të kallëzimit penal nga policia, për çka edhe kishte kaluar afati ligjor prej 24 orësh, prokurori i çështjes është detyruar që të dyshuarin për kryerje të dy veprave të rënda penale ta lirojë në procedurë të rregullt³⁵.

Po ashtu një rast tjetër në Gjykatën Themelore të Gjakovës për veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 275 par.1 dhe 3, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës, Policia ndaj të dyshuarve L. U., T. F. dhe K. R. ka paraqitur me vonesë kallëzimin penal në Prokurorinë Themelore të Gjakovës, në Departamentin për Krime të Rënda, konkretisht te prokurori Agron Matjani. Si rezultat i kësaj prokuroria ka dështuar të bëjë kërkesë për shqiptimin e masës³⁶.

Vonesat e këtyre rasteve janë paraqitur nga zyrtarë të ndryshëm policorë ndaj të cilëve nuk është inicuar asnjë procedurë penale apo disiplinore duke lënë hapësirë që raste të ngjashme të ndodhin edhe në të ardhmen me arsyetimin se afati për dorëzimin e kallëzimit penal është i shkurtër dhe se në praktikë mund të ndodhin raste të ngjashme.

“Detyrim ligjor i prokurorit është të ndërmarrë masa edhe kundër policisë, sepse kur dështon prokurori në paraqitjen e kërkesës dhe arsyetimit për caktimin e masës së paraburgimit, policët duhet të thirren në përgjegjësi, duhet të mirren masa ndaj tyre”.
*Besim Kelmendi – Prokuror në Prokurorinë e Shtetit*³⁷

Dorëzimi me vonesë dhe i pakompletuar i kallëzimeve penale nga ana e policisë, ndikon drejtpërdrejt në performancën e prokurorëve, duke mos u lënë atyre kohë të mjaftueshme për të hartuar kërkesa profesionale për shqiptimin e masës së paraburgimit, të mbështetura në argumente relevante. Prokurorët, zakonisht në raste të tilla kur pranojnë kallëzime të vonuara parashtrojnë kërkesa shabllone duke u thirrur në dispozita procedurale shabllone, pa argumentuar fakte nga rastet konkrete, gjë që e gjithë barra bie në gjyqtarin e procedurës paraprake për të argumentuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së paraburgimit.

³⁵ Prokuroria Themelore Gjakovë; PP- 1651/15

³⁶ Gjykata Themelore Gjakovë; PP/I nr.62/16

³⁷ BIRN Kosova; Raporti i Monitorimit të Gjykatave; Prishtinë 2016, fq 12

Në në praktikë nuk janë të rralla rastet kur gjykata e shkallës së dytë këto vendime i prish në mungesë të argumentimit të mirë të rastit konkret.

“Sa i përket paraburgimit, shqetësimi më i madh është koha - afati 24 orësh, sidomos te veprat penale ku ka shumë të pandehur ku duhet të merren disa veprime, është shumë afat i shkurtër. Problemi serioz që kemi hasur është vazhdimi i paraburgimit, aty duhet arsyetuar mirë dyshimi pse i pandehuri duhet të qëndrojë në paraburgim”.
*Admir Shala – Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prizren*³⁸

Në këtë kuptim, policia duhet të kujdeset dhe ta trajtojë me prioritet dorëzimin e kallëzimeve penale në prokurori në kohë sa më të shkurtër, për shkak se mos dorëzimet në kohë dhe vonesat e paarsyeshme krijojnë zinxhirë problemesh nga policia në prokurori e deri në gjykatë, duke bërë që kryes të veprave penale të rënda të lirohen në procedurë të rregullt pa u shqiptuar ndonjë masë për sigurinë e prezencës së tyre në procedurë. Kjo krijon rrezik të madh që kryes të tillë të arratisen dhe të mos gjykohen fare, duke treguar edhe jo profesionalizëm dhe mos efikasitet të sistemit gjyqësor në kapjen dhe dënimet e kryesve të veprave penale. Po ashtu kjo nuk e përjashton mundësin e privimit nga liria personave që gabimisht janë të dyshuar për ndonjë vepër penale, duke cenuar kështu të drejtat themelore të njeriut.

2.3.2 Dështimi i arsyetimeve të vendimeve për caktimin e masës së paraburgimit, si nga prokuroria po ashtu edhe nga gjyqtaret e procedurës paraprake

Sipas Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale dhe se çdo person që arrestohet dhe burgoset në kundërshtim me argumentimin e mirë për qëndrim në paraburgim ka të drejtën në dëmshpërblim³⁹. E gjithë barra për arsyeshmërinë e qëndrimit të një personi në paraburgim bie mbi prokurorin i cili duhet të argumentojë dyshimin e bazuar para gjykatës të mbështetur në prova dhe fakte që një person ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet dhe se i njëjti duhet të qëndrojë në paraburgim.

Procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston ky dyshim i bazuar se është kryer vepër penale⁴⁰. Në praktikë ka raste kur prokurorët nuk kanë

³⁸ BIRN Kosova; Raporti i Monitorimit të Gjykatave; Prishtinë 2016, fq 14

³⁹ Neni 5 par.1 dhe 3 KEDNj.

⁴⁰ Shih neni 6 par.2 i KPPRK-së

arritur të dëshmojnë me prova të artikulueshme “dyshimin e bazuar” para gjykatësit të procedurës paraprake se i dyshuari ka kryer veprën penale. Në shumë raste prokurorët paraqesin propozimet e tyre në shabllone, vetëm duke u mbështetur në ekzistencën e tri kushteve të parapara në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për caktimin e masës së paraburgimit nga neni 187 par.1 të KPPRK-së, ndërsa kanë dështuar të arsyetojnë me saktësi provat që kanë të bëjnë drejtpërdret me rastin konkret.

Propozimet e prokurorëve edhe pse të paarsyetuara si duhet nuk kundërshtohen dhe në të shumtën e rasteve ato aprovohen nga gjykatësit e procedurës paraprake. Nuk janë të rralla rastet kur këta të fundit kanë dështuar në arsyetimet e tyre për caktimin e masës së paraburgimit dhe gjykata e shkallës së dytë këto vendime të paarsyetuara i ka prishur. Rastet në vijim shërbejnë si shembuj të vendimeve të paarsyetuara si duhet nga prokurorët dhe gjykatësit e procedurës paraprake:

Në Gjykatën Themelore të Gjakovës, ndaj të pandehurit E.N. për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 273 par.2 të KPRK-së, gjykata e shkallës së dytë ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë të gjyqtarit të procedurës paraprake, me të cilin të pandehurit i ishte caktuar një muaj paraburgim, duke e zëvendësuar me masën e arrestit shtëpiak⁴¹. Apeli në arsyetim të vendimit të saj konstatoi se vendimi i Gjykatës Themelore të Gjakovës ishte i paarsyetuar dhe jo i duhur për rastin konkret⁴².

Një rast të cilin nuk mund pa e përmendur në Prishtinë⁴³, rast i cili kishte bërë bujë në media, tregon më së miri dështimin e arsyetimit të vendimeve për paraburgim. Në këtë rast i dyshuar ishte ish-kryetarit të Gjykatës së Apelit, Salih Mekaj, që po hetohej nga Prokuroria Speciale e Kosovës nën dyshimin për kryerje të veprave penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 i KPRK-së dhe “Ushtrimi i ndikimit” nga neni 431 i KPRK-së, fillimisht prokurorja e rastit Drita Hoxha kërkoi që ndaj tij të caktohet masa e paraburgimit, mirëpo në mungesë të argumentimit të duhur, gjykata e shkallës së parë, konkretisht gjykatësi Vehbi Kashtanjeva vendosi që ndaj tij të caktohet masa e arrestit shtëpiak⁴⁴.

⁴¹ Gjykata Themelore në Gjakovë; PPr.Kr.nr. 71/16

⁴² Gjykata e Apelit të Kosovës; PN.1.nr.984/16

⁴³ Gjykata Themelore në Prishtinë lënda me numër PKR.nr.263/2015

⁴⁴ Gjykata Themelore në Prishtinë; PKR.nr.263/2015

Ndërsa pas ankesës së mbrojtjes në Gjykatën e Apelit, kolegji i kësaj gjykate vendimin me të cilin i është caktuar masa e arrestit shtëpiak të dyshuarit e quajti “për keqardhje” dhe atë masë e zëvendësoi me masën e ndalimit për t’iu ofruar vendit apo personit të caktuar. Në aktvendimin e Gjykatës së Apelit ndër të tjera thuhet se gjykata e cakton arrestin shtëpiak kur prokurori i shtetit kërkesën e vet e ka arsyetuar dhe e ka mbështetur në prova të pakontestueshme⁴⁵.

“Propozimi i prokurorit për paraburgim sa i përket bazave ligjore nga pika 1.2.1. dhe 1.2.3 të nenit 187 të KPPRK-së, nuk përfshinte asnjë provë që ligji kërkon përpos një përrshkrimi fjalë për fjalë të normës ligjore. Është për keqardhje që gjykatat propozimet e tilla të paarsyetuara fare, si zakonisht pa asnjë vlerësim kritik i akcepton”⁴⁶.

Po ashtu në aktvendimin e Gjykatës së Apelit thuhet se gjykata e shkallës së parë pos që vendimin nuk e mbështet në prova, madje bën edhe konstatime paushalle.

“Jo vetëm që janë të pa mbështetura në prova fare, por janë edhe konstatime paushalle të gjykatës së shkallës së parë kur thekson se “të pandehurit nuk do të hezitojnë që të kryejnë vepra tjera penale!!!” dmth sipas këtij konstatimi, ata nëse ndodhen në liri do t’i përsërisin veprat tjera penale!???. Ky konstatim është puro arbitrar, ngase para së gjithash për të pandehurin e parë bëhet fjalë për një gjyqtar që asnjëherë në jetën e gjertanishme të jetës së tij nuk ka ardhë në konflikt me ligjin, është njeri familjar, i moshuar dhe gjithashtu nuk rezulton se edhe e pandehura e dytë ndonjëherë ka qenë e skeduar penalisht”⁴⁷.

Rasti konkret është shembulli tipik i prezantimit të gjendjes reale në teren ku fillimisht prokuroria nuk arrin ta argumentojë dhe arsyetojë kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit, pastaj edhe gjykata e vazhdon këtë trend, duke mos e arsyetuar si duhet edhe masën tjetër, atë të arrestit shtëpiak.

Vlen të theksohet që prokurorët por edhe gjykatësit me rastin e kërkesës dhe caktimit të masës së paraburgimit nuk vlerësojnë fare shpenzimet e buxhetit shtetëror për qëndrimin e një të pandehuri në paraburgim, ku një ditë qëndrimi në paraburgim për një person vlerësohet

⁴⁵ Gjykata e Apelit të Kosovës; PN.nr.1431/2015

⁴⁶ Po aty

⁴⁷ Po aty

t'i kushtojë buxhetit hiç më pak se 29- 30 euro⁴⁸. Me rastin e kërkesës për caktimin e paraburgimit prokurorët, duhet të bëjnë më shumë përpjekje për të arsyetuar kërkesat e tyre me arsye adekuate për rastet konkrete, vetëm atëherë kur kjo masë është e domosdoshme. Poashtu, gjykatësit e procedurës paraprake duhet t'i kundërshtojnë kërkesat e prokurorisë atëherë kur ato nuk janë të argumentuara mirë, e kurrësi që vet të marrin vendime të paarsyetuara për caktimin e masës së paraburgimit.

“Të aplikohen edhe masa të tjera të cilat i parasheh kodi, sepse kemi masa që nuk janë aplikuar kurrë”⁴⁹. Afërdita Bytyqi – Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Nëpërmjet këtyre tabelave⁵⁰ jepet një pasqyrim i saktë dhe konciz i zbatueshmërisë apo moszbatueshmërisë së masave për sigurimin e prezencës së të pandehurit në Gjykatën Themelore të Gjakovës dhe krahasohet lakorja e shqiptimit nga viti në vit.

MASAT	2014	2015	2016	2017	2018
Thirrja	///	///	///	///	///
Urdherarresti	0	0	0	0	0
Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin	0	0	0	0	0
Ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar	0	0	0	0	0
Paraqitja në stacionin policor	12	8	8	3	8
Dorëzania	0	0	0	0	0
Arresti shtëpiak	10	8	8	10	5
Diversio	0	0	0	0	0
Paraburgimi	32	28	41	40	51
Refuzimi i mases	0	0	0	0	0
Totali i lëndëve gjatë vitit	252	152	205	259	402

Statistika nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal.

⁴⁸ Raporti i Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës; QKRMT 2014; fq 55

⁴⁹ BIRN Kosova; Raporti i Monitorimit të Gjykatave; Prishtinë 2016; fq 18

⁵⁰ Agj.II.8/20; Statistika; Gjykata Themelore Gjakovë

MASAT	2014	2015	2016	2017	2018
Thirrja	///	///	///	///	///
Urdherarresti	0	0	0	0	0
Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin	0	0	0	0	0
Ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar	0	0	0	0	0
Paraqitja në stacionin policor	2	1	0	1	0
Dorëzania	0	1	0	0	0
Arresti shtëpiak	16	5	8	7	2
Diversio	0	0	0	0	0
Paraburgimi	51	46	37	39	32
Refuzimi i masës	0	0	0	1	0
Totali i lëndëve gjatë vitit	163	152	151	103	76

Statistika nga Departamenti për Krime të Rënda

Ajo që vërehet në të dy departamentet është se numri i kërkesave për masën e paraburgimit është mjaft i lart krahasuar me masat e tjera të parapara me këtë kod. Po ashtu, vërehet që refuzimi i këtyre kërkesave nga Gjykata Themelore e Gjakovës, pothuaj se nuk ekziston fare, përjashtuar një rast të vetëm në vitin 2017, në Departamentin e Krimeve të Rënda, Gjykata e kishte refuzuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë

2.3.3 Stërzgjatja e paraburgimeve në pritje të gjyqimit të të akuzuarve dhe shqyrtimit të dytë, si kritere ligjore për analizimin e masës së paraburgimit

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton qartë se heqja e lirisë duhet të trajtohet me shpejtësi: “Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme”⁵¹. Edhe Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, në nenin 5, e ka të përcaktuar parimin për “Gjykim të drejtë, të paanshëm dhe në afat të arsyeshëm”. Edhe pse konventa nuk përcakton saktë kohën sa një i pandehur duhet të qëndrojë në paraburgim. Afati kohor sa i përket qëndrimit në paraburgim para ngritjes së aktakuzës është specifikuar në Kodin e Procedurës Penale të

⁵¹ Shih neni 5 par.3 i KEDNJ-së

Republikës së Kosovës, sipas të cilit para ngritjes së aktakuzës për vepra të rënda penale paraburgimi mund të zgjasë më shumti deri në një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej tetëmbëdhjetë (18) muajsh⁵².

Edhe pse askund në kod nuk është precizuar koha e saktë se sa një i akuzuar mund të qëndrojë në paraburgim pas ngritjes së aktakuzës, megjithatë është përcaktuar saktë sa duhet të jetë koha për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda nëntëdhjetë (90) ditësh, ndërsa nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda njëqindnjëzet (120) ditëve, me mundësi vazhdimi edhe për tridhjetë (30) ditë të tjera, në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme të numrit të madh të provave dhe dëshmitarëve⁵³.

Rastet në vijim shërbejnë si shembuj të rasteve kur të pandehurit mbahen në paraburgim për periudhë të gjatë kohore dhe shqyrtimet gjyqësore zgjasin me vite të tëra.

Në Gjakovë, i akuzuari me inicialet N. Sh. akuzohet për vepër penale të vrasjes nga neni 178 i KPRK-së, si dhe vepra penale e mbajtjes në pronësi, kontroll, ose posedim i paautorizuar i armëve, nga neni 374 par.1 i KPRK-së. Ai, qëndroj në paraburgim nga data 11.03.2013 deri më 17.11.2016 ku edhe është gjykuar dhe shpallur fajtor. Pavarësisht veprës penale të kryer, qëndrimi në paraburgim afro 4 vjet, përkatësisht 3 vjet e 8 muaj është stërzgjatje e qëndrimit nën këtë masë, e cila tejkalon çdo kufi për gjykim të drejtë dhe në afat të arsyeshëm të paraparë si në konventat evropiane ashtu edhe në ligjin vendorë.⁵⁴

Po ashtu në Gjykatën Themelore të Gjakovës në lëndën ku i akuzuari F. G. u mbajt në masën e paraburgimit mbi tri (3) vjet, nga data 09.05.2014 deri më 21.06.2017 datë kjo e shpalljes së aktgjykimit. Këtë lëndë të cilën e ka gjykuar gjykatësi Gëzim Pozhegu, vazhdon të jetë edhe sot me ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës⁵⁵. Qëndrimi në paraburgim mbi tri (3) vjet pa asnjë aktgjykim, tejkalon çdo kufi për gjykim të drejtë dhe shqetëson palën e dëmtuar. Këto raste dëshmojnë për zvarritjen dhe stërzgjatjen e procedurave gjyqësore duke tejkaluar çdo afat ligjor dhe duke cenuar seriozitë garantimin e lirive themelore të njeriut.

⁵² Neni 190 par.2 pika 1 dhe 2, par.3 dhe 4 të KPRK-së

⁵³ Neni 314 par.1,2 dhe 3 të KPRK-së

⁵⁴ Gjykata Themelore në Gjakovë; PKR.nr. 250/13; këtë rast e ka gjykuar ish gjykatësi, tani i dalur në pension Hilmi Hoxha, pas pensionimit të tij rastin e ka marrë gjykatësi Gëzim Pozhegu me anëtarët e trupit gjykues Manduhije Sylja dhe Ilir Rashkaj

⁵⁵ Gjykata Themelore në Gjakovë; PKR.nr. 61/14

Në tabelën e mëposhtme⁵⁶ është treguar kompensimi që është bërë personave që janë mbajtur në paraburgim pa bazë nga gjykatat e Kosovës, nga viti 2004 deri në vitin 2019.

Viti	Numri i rasteve	Shuma e shpenzuar	Mesatarja e ditëve me burgim për person gjatë vitit
2004	14	31,387.62	112
2005	75	156,259.47	104
2006	63	188,821.20	149
2007	80	268,482.96	167
2008	61	270,116.88	221
2009	51	107,887.86	105
2010	63	176,913.00	140
2011	88	189,384.19	107
2012	80	158,324.13	100
2013	86	266,374.25	154
2014	75	279,589.00	186
2015	120	380,288.00	158
2016	148	368,212.00	124
2017	153	385,470.30	126
2018	185	463,353.24	125
2019	188	455,011.41	121
Total		4,145,875.51	

Statistika nga Këshilli Gjyqësorë i Kosovës

Duke u bazuar në faktin se paraburgimi duhet të reduktohet në kohën sa më të shkurtër të mundshme, kur i pandehuri mbahet në paraburgim, të gjitha organet që marrin pjesë në procedurën penale dhe organet që ofrojnë ndihmën juridike detyrohen të veprojnë me nguti të posaçme⁵⁷. Gjykatat duhet të kenë më shumë kujdes dhe të trajtohen me prioritet lëndët në të cilat ka të akuzuar që ndodhen në paraburgim, ato duhet t'i përmbahen më me kujdes zbatimit të dipozitave ligjore të përcaktuara në kodin e procedurës penale të cilat rregullojnë kohëzgjatjen e paraburgimit dhe kohëzgjatjen e fillimit dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

⁵⁶ Nr.09/688; Këshilli Gjyqësor i Kosovës

⁵⁷ Shih neni 185 par.2 i KPRK-së

2.3.4 Mos respektimi i afateve ligjore për caktimin e shqyrtimit fillestar

Me ndryshimet në kodin e ri të procedurës penale në vitin 2013, janë paraparë edhe afatet kohore brenda të cilave duhet të mbahen seancat gjyqësore. Pas ngritjes së aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet të caktojë menjëherë shqyrtimin fillestar i cili duhet të mbahet brenda 30 ditëve nëse i pandehuri gjendet në liri, ndërsa nëse i pandehuri është në mbajtje në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e parë, jo më vonë se 15 ditë pas ngritjes së aktakuzës⁵⁸. Pas shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se 30 ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se 40 ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se 30 ditë nga shqyrtimi fillestar⁵⁹.

Edhe përkundër faktit se Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës parasheh afate strikte sa i përket caktimit të këtyre seancave gjyqësore, Raporti ka hasur në raste kur këto afate nuk janë respektuar nga gjyqtarët e procedurës paraprake.

Rast tipik i mosrespektimit të afateve është rasti i ish kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Enver Hasani. Në seancën gjyqësore të mbajtur në Gjykatën Themelore të Prishtinës në shtator 2016, për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, aktakuza ndaj të pandehurit Enver Hasani ishte ngritur më 13 janar 2016, ndërsa seanca fillestare është mbajtur tek më 8 shtator 2016, përkundër faktit që Kodi i Procedurës Penale të Kosovës përcakton se seanca fillestare mbahet 30 ditë pas ngritjes së aktakuzës⁶⁰.

Rastet e tilla të caktimit të seancave fillestare deri në gjashtë muaj pas ngritjes së aktakuzës në rastet kur të akuzuarit gjenden në paraburgim, konsiderohen neglizhencë e drejtpërdrejtë e gjyqtarëve dhe dështim i tyre për të kryer lëndët në afatet e parapara ligjore. Vazhdimi edhe më tutje i lejimit të tejkalimit të afateve gjyqësore ndikon në mos efikasitetin e gjyqësorit për trajtimin e lëndëve në afat të arsyeshëm ndaj kryesve të dyshuar të veprave penale të cilët ndodhen në masën e paraburgimit.

⁵⁸ Shih nenin 242 par.4 dhe 5 të KPRK-së

⁵⁹ Shih nenin 245 par.5 të KPRK-së

⁶⁰ Gjykata Themelore në Prishtinë; PKR.nr.14/16; kryetari i trupit gjykues Shasivar Hoti, prokurori Abdurrahim Islami, i akuzuari Enver Hasani me avokat Bajram Tmava.

KREU III: ANALIZË KRAHASUESE TË MASAVE TË SIGURIMIT SIPAS LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS DHE ATI TË MAQEDONISË

3.1 Ngjashmëritë dhe dallimet e masave të sigurimit në RKS-së dhe RMV-së

Ligji i Procedurës Penale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka hyrë në fuqi më 1.12.2013. Ky ligj përbëhet nga tri (3) pjesë ku konkretisht: pjesa e parë “Dispozita të përgjithshme”, pjesa e dytë “Rrjedha e procedurës, seksioni A. Procedura paraprake” dhe pjesa e tretë “Procedurat e veçanta”. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit janë përfshirë në pjesën e parë, kreu gjashtëmbëdhjetë.

Kodi ynë i Procedurës Penale, është miratuar më 21.12.2012 dhe ka hyrë në fuqi më 1.1.2013. Ky kod përbëhet nga 5 (pesë) pjesë ku konkretisht: pjesa e parë “Dispozita të përgjithshme”, pjesa e dytë “Procedura penale”, pjesa e tretë “Administrimi i procedurës”, pjesa e katërt “Procedurat e veçanta” dhe pjesa e pestë “Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare”. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit janë përfshirë në pjesën e dytë, kapitulli dhjetë. Duke qenë se kodi ynë i procedurës penale dhe ligji i procedurës penale të Maqedonisë së Veriut janë relativisht të vonshëm dhe janë ndërtuar mbi bazën e legjislacioneve të shteteve të BE-së dhe kanë huazuar më të mirën e kodeve të shteteve të tjera, ndryshimet do të jenë të pakta, pasi ngjashmëritë dominojnë.

Në kodin tonë të procedurës penale, parashikohen nëntë (9) masa sigurimi, po ashtu sipas dispozitave të ligjit të procedurës penale të RMV-së, masat e sigurimit janë nëntë (9), por me disa ndryshime. Kodi ynë i procedurës penale në nenin 173 të tij, ku dispozita e parë e masave të sigurimit nis me dispozitën e përgjithshme, në të cilën sanksionohet fakti se liria e personit mund të kufizohet vetëm sipas dispozitave të këtij kodi dhe vetëm me anë të masave të sigurimit të numëruara nëntë në mënyrë taksative.

Situatë e njëjte paraqitet edhe nenin 144 të LPP-së, ku dispozita e parë e masave të sigurimit fillon me dispozitën e përgjithshme, duke i numëruar në mënyrë taksative llojet e masave të parapara me këtë ligj të cilat mund të ndërmerren ndaj të akuzuarit për të siguruar prezencën e tij dhe për udhëheqjen pa pengesë të procedurës penale.

Një dallim që e karakterizon LPP-në në kuadër të renditjes dhe llojit të masave të sigurimit në Republikën e Maqedonisë Veriore, është ajo në nenin 146 ku parashihet “Masat e parandalimit”. Kjo masë ngërthen në vetë shtatë lloje të masave të numëruara në mënyrë

taksative siç janë; ndalim për lëshimin e vendbanimit,⁶¹ që të lajmërohet te personi i caktuar zyrtar ose te organi shtetëror,⁶² konfiskim i përkohshëm i dokumentit të udhëtimit,⁶³ konfiskim i përkohshëm i patentë shoferit,⁶⁴ ndalim për vizitë në zonës së caktuar,⁶⁵ ndalim për vendosjen e kontakteve me persona të caktuar⁶⁶ dhe ndalim për ndërmarrjen e aktiviteteve të caktuara të cilat janë të lidhura me veprën penale.⁶⁷ Një masë kaq të gjerë nuk e hasim në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

Në pikën tre të nenit 173 të KPPRK-së, parashikohet heqja e masave të sigurimit në momentin e pushimit të shkaqeve të cilat e kanë motivuar ekzistencën e tyre dhe në qoftë se plotësohen kushtet zëvendësimi i kësaj mase me një masë tjetër më të butë. E njëjta gjë parashikohet dhe në LPP nenin 144, ku shprehimisht në paragrafin e dytë thuhet se, gjatë vendimmarrjes se cilën nga masat do ta zbatojë, organi kompetent do tu përmbahet kushteve të përcaktuara për zbatimin e masave të veçanta, duke mbajtur llogari që të mos zbatohet masë më e rëndë nëse mundet që qëllimi i njëjtë të arrihet me masë më të butë. Gjithashtu në paragrafin e tretë parashikohet zëvendësimi i masës me një më të lehtë në momentin kur nevojat e sigurimit zbuten ose heqjen e tyre sipas detyrës zyrtare kur do të pushojnë kushtet ligjore⁶⁸.

Kodi i Procedurës së Kosovës në nenin 175 paragrafi 1, parashikon se kërkesën për të lëshuar gjykatësi urdhërarrestin e bën prokurori i shtetit ose në raste të ngutshme edhe policia. Ndërsa në LPP të Maqedonisë Veriore parashikohet pak më ndryshe ku në nenin 157 paragrafi 1, thuhet se urdhri për arrestimin e të akuzuarit mund të japë gjykata nëse ekzistojnë baza për paraburgim nga neni 165 i këtij ligji. Dhe për sa i përket organit ekzekutues të urdhërarrestit, të dy ligjet respektivisht kodi parashikojnë organe të ngjashme të ngarkuara me këtë detyrë, ku në KPPRK, konkretisht në nenin 175 paragrafi 3 dhe në LPP neni 157 paragrafi 2 parashikohet se këtë detyrë e ka policia.

Në kodin tonë parashikohet dispozita “Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin”, neni 176, i cili shpreh se në këtë rast gjykata nuk shprehet me vendim por kërkon premtimin e të pandehurit se nuk do të fshihet ose largohet nga vendqëndrimi pa lejen

⁶¹ Shih paragrafin 1 pika 1 të nenit 146 të LPP-së

⁶² Shih paragrafin 1 pika 2 të nenit 146 të LPP-së

⁶³ Shih paragrafin 1 pika 3 të nenit 146 të LPP-së

⁶⁴ Shih paragrafin 1 pika 4 të nenit 146 të LPP-së

⁶⁵ Shih paragrafin 1 pika 5 të nenit 146 të LPP-së

⁶⁶ Shih paragrafin 1 pika 6 të nenit 146 të LPP-së

⁶⁷ Shih paragrafin 1 pika 7 të nenit 146 të LPP-së

⁶⁸ Shih neni 173 të KPPRK-së dhe neni 144 të LPP-së

e gjykatës kur ekziston dyshimi i bazuar se ai ka kryer vepër penale dhe ka arsye se i pandehuri mund të fshihet, të shkojë në vend të panjohur ose të largohet nga Kosova. Ky premtim shënohet në procesverbal dhe mund të shoqërohet me konfiskim të dokumentit të udhëtimit. I pandehuri paralajmërohet se nëse e shkelë premtimin e dhënë mund të caktohet masa më e rëndë ndaj tij, ajo e paraburgimit. Ndërsa LPP-ja, e ka parashikuar këtë dispozitë në kuadër të “Masat parandaluese” paragrafi 1 pika 1 i cili shpreh se me vendim gjyqtari urdhëron të pandehurin të mos largohet nga territori shtetëror. Pra këtu kemi të bëjmë me një vendim gjykatë që ndalon, ndërsa KPPRK-ja kërkon premtim.

Të dy kodi-ligji parashikojnë masën e ndalimit për të iu afruar vendit ose personit të caktuar. Me disa ndryshime të tilla si, kodi ynë këtë dispozitë e ka të paraparë në neni 177 ku përmban tetë (8) paragrafë që specifikojnë të gjitha detajet. Kjo masë në LPP është e paraparë në nenin 146 paragrafi pesë (5) në kuadër të masave të parandalimit⁶⁹.

Kemi ngjashmëri në të dy kodet për sa i përket masës së detyrimit për tu paraqitur në organin shtetërorë ose në polici, sipas kodit-ligjit përkatës⁷⁰. Dhe në këtë dispozitë ndryshimet konsistojnë në parashikimet që i bën kodi i Kosovës, të kushteve për të vendosur këtë masë. Ndërsa LPP-ja këtë masë e ka të paraparë në kuadër të “Masave të parandalimit”. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, i jep një vëmendje kësaj mase duke i kushtuar asaj disa nene. Mendoj, duke analizuar të shtatë nenet që parashikon ky kod rreth paraqitjes në stacion policor, se gjithçka është sqaruar në mënyrë specifike.

Një masë shumë e rëndësishme që i jep mundësi të pandehurit të procedohet nga liria, me kusht që të paraqitet në organin procedues është “Dorëzania”, parashikuar nga neni 179 i kodit tonë. Sipas kësaj dispozite, vet i pandehuri ose një person që meriton besim nënshkruajnë një deklaratë me të cilën ata deklarojnë se pranojnë të depozitojnë një shumë të caktuar nga gjykata në bankë, e cila shërben si garanci e paraqitjes së të pandehurit në organin e procedues.

Të njëjtën dispozitë e hasim dhe të LPP-ja, por me disa ndryshime duke nisur që nga emërtimi i dispozitës, konkretisht në këtë ligj emërtohet “Garancia”, neni 150. Kjo dispozitë parashikon kur i pandehuri mund të mbrohet në liri me dorëzani ose të lirohet nga paraburgimi me dorëzani. Të dy procedurat penale, si ajo e Kosovës dhe ajo e Maqedonisë

⁶⁹ Shih neni 177 të KPPRK-së dhe paragrafi 5 i nenit 146 të LPP-së

⁷⁰ Shih neni 178 të KPPRK-së dhe neni 146 të LPP-së

Veriore i japin një vëmendje kësaj mase duke i kushtuar asaj disa nene, ku gjithçka është sqaruar në mënyrë specifike.

“Arresti shtëpiak”, është një masë të cilën e ndeshim shpesh në praktikën gjyqësore. Ngjashmëria midis dy kodeve konsiston në kuptimin rreth arrestit në shtëpi, ku kodi ynë në nenin 183 paragrafi 3, parashikohet se: *“Gjykata me aktvendim vendos se i pandehuri nuk guxon të largohet nga lokalet ku ai e ka vendbanimin ose vendqëndrimin apo nga institucioni publik për trajtim ose përkujdesje. Gjykata mund ta kufizojë ose ndalojë kontaktin nëpërmjet të pandehurit dhe personave me të cilët ai nuk jeton apo nuk janë të varur nga i pandehuri. Përgjatimisht, gjykata mund të lejojë të pandehurit që për kohë të caktuar të largohet nga lokalet ku mbahet arresti shtëpiak kur kjo është e domosdo e nevojshme për përmbushjen e nevojave jetësore ose për kryerjen e ndonjë pune”*. Ndërkohë në nenin 163 paragrafi 1 i LPP-së, parashikohet se: gjykata mund të përcaktojë masë arresti shtëpiak dhe t'i urdhërojë atij personi që të mos e lëshojë shtëpinë për një kohë të caktuar. Paragrafi 2 i këtij neni thotë se *personit kundër të cilit është përcaktuar arresti shtëpiak mundet me përjashtim t'i lejohet që të largohet për një kohë të caktuar nga banesa apo lokali tjetër: nëse kjo nuk është e nevojshme për mjekim apo nëse atë e kërkojnë rrethana të veçanta për të cilat mund të shkaktohen pasoja të dëmshme për jetën, shëndetin apo pasurinë e personit apo të afërmeve të tij*. Një dallimi mes këtyre dispozitave konsiston në veprimet e gjykatës nëse personi kundër të cilit është caktuar arresti shtëpiak largohet nga shtëpia apo lokali në kundërshtim me ndalimin e gjykatës. Sipas paragrafit 5 të nenit 183 të KPPRK-së, *“gjykata mund të caktojë paraburgim nëse i pandehuri pa leje shkel aktvendimin”*. I pandehuri për këto pasoja gjithmonë duhet njoftuar me kohë sipas kësaj dispozite. Ligji i Procedurës Penale të Maqedonisë Veriore, në paragrafin 4 të nenit 163 parashikon arrestim të shoqëruar me vërejte.

Në Kodin e Procedurës së Kosovës, në rrethin e masave të butave është dhe “Diversioni” neni 184, një masë e tillë nuk ekziston në ligjin e Procedurës Penale të Maqedonisë Veriore. Kur i pandehuri plotëson disa kushte: kur është arrestuar për një vepër penale për të cilën dënimi maksimal është jo më shumë se një vit dhe i cili nuk ka dënime të mëparshme ose nuk ka marrë pjesë në diversion me urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake mund t'i caktohet kjo masë.

“Paraburgimi”, është masa më e rëndë prandaj kërkon një vëmendje më të madhe, pasi cenon drejtpërdrejtë lirinë e individit. Masat më të buta për sigurimin e pranisë së të

pandehurit të parapara në nenin 173 të KPPRK-së do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë, të parandalojë përsëritjen e veprës penale dhe të sigurojë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale. Të njëjtin parashikim bën dhe ligji i Procedurës Penale të Maqedonisë Veriore, konkretisht në nenin 165 “Baza për caktimin e paraburgimit” paragrafi 1 thotë se nëse ekziston dyshim i bazuar se person i caktuar ka kryer vepër penale, ***nëse paraburgimi është i domosdoshëm*** për udhëheqje të papenguar të procedurës penale, kundër atij personi mund të përcaktohet paraburgim. Ndryshimi mes këtyre dispozitave konsiston në atë se LPP-ja përcakton se paraburgimi nuk do të caktohet në bazë të paragrafit (1) pika 2 të nenit 165 (*nëse ekziston frikë e bazuar se do të fshihet, falsifikohen apo shkatërrohen gjurmët e veprës penale, apo nëse rrethana të veçanta sugjerojnë se do ta pengojnë procedurën penale me ndikim mbi dëshmitarët, ekspertët, bashkëpjesëmarrësit apo fshehësit*), nëse i akuzuari ka dhënë deklaratë me të cilën e ka pranuar fajin. Ndërsa në kodin tone kjo situatë nuk është e përcaktuar.

3.2 Kushtet e përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit

Masat e sigurimit mund të caktohen vetëm kur ekzistojnë dhe provohen kushtet e kriteret e përcaktuara me ligj. Në kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në Kodin e Procedurës Penale janë parashikuar dhe detajuar këto kushte e kriteret për masat e sigurimit në përgjithësi dhe për atë që sjell heqjen e lirisë.

Në nenin 29 të Kushtetutës është sanksionuar se: “*Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente*”. Në pikën dy të këtij neni është parashikuar që liria e personit mund të hiqet “*për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj*”. Në një rast të tillë, në bazë të paragrafit dy të po të njëjtit nen të Kushtetutës, personi të cilit i është hequr liria brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirinë e tij.

Në pajtim të plotë me nenin 29 të Kushtetutës dhe në bazë të dispozitave të KPPRK-së, të nenit 173 që bën fjalë për masat e sigurimit, ku është zbërthyer dhe konkretizuar rasti që personit mund t’i hiqet liria dhe neni 187 ku janë paraparë kushtet e posaçme për caktim të paraburgimit.

Si kushte të përgjithshme që paraqiten për caktimin e masave të sigurimit, që janë: a) dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova; b) ekzistenca e veprës penale; dhe c) ekzistenca e kushteve të dënueshmërisë sipas të drejtës penale materiale⁷¹.

I pari dhe më i rëndësishmi është kushti, sipas të cilit askush nuk mund tu nënshtrohet masave të sigurimit (masat e drejtuara ndaj të pandehurit) në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. Dyshimi i arsyeshëm nënkupton bindjen që krijohet nga provat e marra dhe të shqyrtuara në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat, në tërësinë e tyre, tregojnë se vepra penale ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga ai që pandehet⁷².

Kushti tjetër i përgjithshëm për caktimin e masave të sigurimit është ekzistenca e veprës penale. Ky kusht kërkon që fakti i dhënë të jetë parashikuar nga Kodi Penal si veprim i ndaluar dhe që vepra penale të mos jetë shuar si rezultat i parashkrimit apo ndonjë rrethane tjetër⁷³.

Kushti i tretë i përgjithshëm për caktimin e masës së sigurimit është përgjegjshmëria e atij që u nënshtrohet masave të sigurimit. Në këtë kuptim asnjë masë siguri nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie, siç është gjendja mendore ose çdo arsye tjetër ligjore që përjashton nga përgjegjësia penale (mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme etj.)⁷⁴.

Të tria kushtet e karakterit të përgjithshëm duhet të ekzistojnë dhe të vërtetohen njëkohësisht dhe bashkërisht në çdo rast konkret. Nuk mjafton vetëm ekzistenca e dyshimit të bazuar në prova, por duhet të vërtetohet që fakti përbën vepër penale, dhe ai që dyshohet për kryerjen e saj të jetë i përgjegjshëm penalisht. Që të tria këto kushte duhen të plotësohen në të dy legjislacionet, si në atë të Republikës së Kosovës dhe në atë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3.3 Kushtet për caktimin e paraburgimit si masë më e rëndë për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale

Në paragrafin e parë të nenit 187 të KPPRK-së, parashikohen kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit ku Gjykata si kusht kryesor kryesorë për ta caktuar këtë masë ndaj

⁷¹ Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Procedura Penale, Tiranë 2011, fq. 315

⁷² Po aty

⁷³ Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Procedura Penale, Tiranë 2011, fq. 317

⁷⁴ Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Procedura Penale, Tiranë 2011, fq. 318

një personi ka vetëm nëse në mënyrë të qartë ka gjetur se ekziston dyshimi i bazuar se personi (pandehuri) ka kryer vepër penale, më pas në baze të këtij kushti duhet të përmbushet njëri nga tri kriteret tjera të përcaktuara me këtë Kod. Sipas paragrafit 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3, këto tri kriteret janë kur identiteti i personit nuk mund të vërtetohet dhe ekziston rreziku i ikjes, kur mund të fshehë, ndryshoj ose falsifikoj provat dhe si kriter i tretë kur ekziston rreziku i përsëritjes së veprës penale apo ta përfundoj veprën e tentuar.

Kjo gjë është e paraparë njëjtë edhe në paragrafin e parë të nenit 165 të Ligjit të Procedurës Paraprake të Republikës së Maqedonisë Veriore, ku parashikohet baza për caktimin e paraburgimit me premisën kryesore nëse ekziston dyshimi i bazuar se personi i caktuar ka kryer vepër penale për të vazhduar më pas me përmbushjen e njëres nga katër kriteret e përcaktuara në mënyrë taksative me këtë Ligj. Këto kriteret janë të ngjashme me ato të KPPRK-së përjashtimisht kriterit të katërt ku sipas paragrafit 1.4 të nenit 165 të LPP-së, është nëse i akuzuari i thirrur në mënyrë të rregullt në mënyrë evidente i shmanget ardhjes në seancën kryesore, ose në mënyrë evidente i shmanget pranimin të thirrjes.

Ndryshimi mes këtyre dispozitave konsiston në parashikimin e kriterëve që i bën brenda kësaj dispozite LPP-ja, ndërsa te kodi ynë kriterin e katërt, atë të shmangies nga procedura e ka të parashikuar në dispozita të tjera. Neni 307 paragrafi 2 i KPPRK-së shprehimisht thotë, *“Kur shihet qartazi se i akuzuari i thirrur me rregull i shmanget paraqitjes së tij në shqyrtim gjyqësor dhe nuk ekzistojnë shkaqe për paraburgimin e tij nga neni 187 i këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të caktojë paraburgim për sigurimin e pranisë së të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor”*.

Në nenin 187 paragrafi 1, pika 1.2 të kodit tonë shpreh qartë se mjafton të përmbushet njëri nga tri kriteret e parashikuar në këtë paragraf që të caktohet masa e paraburgimit, pasi vihet re qartë që në LPP mungon ky parashikim. Në të dy këto dispozita është paraparë njëjtë që paraburgimi hiqet posa të pushojnë arsyet për të cilat është caktuar kjo masë.

3.3.1 Rreziku i ikjes

Sipas KPPRK-së, rreziku i ikjes është kriteri i parë i përcaktuar në paragrafin 1 pika 1.2.1 të nenit 187, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij. Ky si kriter i posaçëm për paraburgim të personit për të cilin ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer vepër penale parasheh fshehjen, mos

vërtetimin e identitetit të të pandehurit, ose ekzistimin e rrethanave të tjera që tregojnë se ekziston rreziku i ikjes së tij.

Përveç fshehjes dhe mos vërtetimit të identitetit të pandehurit, rrethana të tjera që tregojnë ekzistimin e rrezikut të ikjes mund të jenë të ndryshme si p.sh. manifestimi i mos disiplinës ndaj urdhrave të organeve kompetente, rrethanat personale (jeta e mëparshme, sjellja e të pandehurit) dhe rrethanat familjare të cilat mund të jenë me rëndësi për vlerësimin se a ekziston rrezik për ikje⁷⁵.

Të njëjtën dispozitë e hasim dhe te LPP i Maqedonisë së Veriut me kriteret pothuajse identike. Rreziku i ikjes po ashtu është kriteri i parë i përcaktuar në paragrafin 1 pika 1. të nenit 165 të këtij ligji, kur personi fshihet, nëse nuk mund të vërtetohet identiteti i tij apo nëse ekzistojnë rrethana tjera që sugjerojnë për rrezik nga ikja.

3.3.2 Asgjësimi i provave

Në pikën 1.2.2 të nenit 187 të KPPK-së, parashikohet asgjësimi i provave si kriteri i dytë për caktimin e masës së paraburgimit, kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit.

Sipas kësaj pike, ekzistojnë dy baza (kushte) në kuadër të kësaj pike për caktim të paraburgimit; a). kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale që kanë të bëjë me provat materiale dhe b). kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit që kjo ka të bëjë me provat personale. Paraburgimi i caktuar sipas pikës 1.2.2 hiqet sapo të merren ose sigurohen provat për të cilat është caktuar paraburgimi⁷⁶.

Ngjashëm është paraparë edhe në LPP të Maqedonisë së Veriut, ku si bazë për caktim të paraburgimit merret frika e bazuar se do të fshihet, falsifikohen apo shkatërrohen gjurmët e

⁷⁵ Prof.dr.sc Ejup Sahiti, prof.dr.sc Rexhep Murati, Mr. Xhevdet Elshani, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës- Komentar Botimi 1, Prishtinë 2014, fq. 490;

⁷⁶ Prof.dr.sc Ejup Sahiti, prof.dr.sc Rexhep Murati, Mr. Xhevdet Elshani, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës- Komentar Botimi 1, Prishtinë 2014, fq. 490-491

veprës penale, apo nëse rrethana të veçanta sugjerojnë se do ta pengojnë procedurën penale me ndikim mbi dëshmitarët, ekspertët, bashkëpjesëmarrësit apo fshehësit⁷⁷.

3.3.3 Peshë dhe mënyra e kryerjes së veprës penale

Në kodin tonë si kriteri i tretë neni 187 për caktimin e masës së paraburgimit, parashikohet peshë dhe mënyra e kryerjes së veprës penale. Kur peshë e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.

Pika 1.2.3 e nenit 187 të KPPRK-së, parasheh mundësinë e paraburgimit në tri situata në të cilat ekziston rreziku se i pandehuri; a). mund ta përsëris veprën penale; b). mund ta përfundojë veprën e tentuar penale; ose c). Mund ta kryej veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej⁷⁸.

Të njëjtën dispozitë e hasim dhe te LPP i Maqedonisë së Veriut, me kritere pothuajse identike. Pika 3 e paragrafit 1 të nenit 165 të LPP-së thotë se; nëse rrethanat e veçanta e arsyetojnë frikën se do ta përsëritë veprën penale, apo do ta përfundojë veprën penale në tentim apo se ka bërë vepër penale me të cilën kërcënohet. Paraburgimi i caktuar sipas këtyre pikave, në të dy legjislacionet, hiqen sapo të merren ose sigurohen provat për të cilat është caktuar paraburgimi.

KREU IV: INSTITUCIONET QË LUAJNË ROL NË CAKTIMIN MASAVE TË SIGURIMIT

4.1 Roli i Prokurorisë në caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, masat e sigurimit vendosen në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, i cili i paraqet gjykatës kompetente

⁷⁷ Shih neni 165 paragrafi 1 pika 2 të LPP-së

⁷⁸ Prof.dr.sc Ejup Sahiti, prof.dr.sc Rexhep Murati, Mr. Xhevdet Elshani, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës- Komentar Botimi 1, Prishtinë 2014, fq. 491-492

arsyet ku bazohet kërkesa. Neni 165 paragrafi 1,⁷⁹ shprehimisht thotë: “Nëse prokurori i shtetit beson se duhet caktuar masën e paraburgimit, ai i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesë për caktim të paraburgimit, nëse prokurori i shtetit beson se duhet masë më e butë për sigurimin e pranisë së të pandehurit sipas nenit 173 të këtij Kodi, ai paraqet kërkesë për masë më të butë për sigurimin e pranisë së të pandehurit”. Shprehja “masë më e butë për të siguruar praninë e të pandehurit” nënkupton thirrjen, premtimin e të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi për t’iu afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitjen në stacionin policor, dorëzimin, arrestin shtëpiak dhe diversionin.⁸⁰

Brenda njëzetekatër (24) orëve pas arrestimit, prokurori i shtetit i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën për caktimin e paraburgimit.⁸¹ Roli i prokurorisë për caktimin e çfarëdo mase për sigurimin e pranisë së të pandehurit konsiston në kërkesën e parashtruar, vërtetimin e dyshimit të bazuar se personi i arrestuar ka kryer veprën e dyshuar penale dhe të vërtetojë bazat e artikulueshme ligjore që përcaktohen me këtë kod për caktimin e cilësdo nga masat e propozuara në kërkesë të prokurorit të shtetit.

4.2 Roli i Gjykatës në caktimin dhe zbatimin e masës së sigurimit

Masa e sigurimit caktohet nga gjyqtari mbi kërkesën e prokurorit, së cilës i bashkohen të dhënat dhe aktet që tregojnë se ekzistojnë kushtet dhe plotësohen kriteret për caktimin e masës. Në diskrecion të prokurorit është vetëm parashtrimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, ndërsa vendimmarrja për të pranuar këtë kërkesë dhe më pas caktimi i masës së sigurimit, është në diskrecion vetëm të gjykatës. Neni 173 paragrafi 5 parasheh se para ngritjes së aktakuzës vendimet lidhur me këto masa i merr gjyqtari i procedurës paraprake, kurse pas ngritjes së aktakuzës vendimet i merr kryetari i trupit gjykues.

Pra vetëm një organ si gjykata ka kompetence për të pranuar dhe caktuar një masë sigurimi të caktuar pasi prokurori ka bërë kërkesë për të vendosur një masë sigurimi, gjykata verifikon nëse ekzistojnë realisht nevojat e sigurimit dhe nëse ekzistojnë kushtet për caktimin e masës së sigurimit personal dhe duke verifikuar rrethanat faktike përcakton llojin e masës së sigurimit në përputhje me kriteret ligjore, me kushtin e vetëm që masa të mos jetë më e rëndë se ajo që kërkohet nga prokurori.

⁷⁹ Shih nenin 165 të KPPRK-së

⁸⁰ Shih nenin 173 paragrafi 5 të KPPRK-së

⁸¹ Shih nenin 164 paragrafi 7 të KPPRK-së. Kjo dispozitë përdoret përshtatshëm për të gjitha masat e tjera të parapara në këtë kod të procedurës.

Neni 165 paragrafi 3,⁸² shprehimisht thotë: “Nëse prokurori i shtetit në kërkesën për caktimin e paraburgimit nuk arrin të vërtetoj dyshimin e bazuar se personi i arrestuar ka kryer veprën e dyshuar penale, gjyqtari i procedurës paraprake e liron të pandehurin.”

Po ashtu, gjatë zhvillimit të procedurës dëgjimore (paraprake) nëse prokurori i shtetit në kërkesën për caktimin e paraburgimit nuk arrin të vërtetojë bazat e artikuleshme për të besuar cilindo nga tri elementet e parapara në mënyrë taksative, siç është rreziku i arratisjes së personit të arrestuar, rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale apo mund ta përfundojë veprën e tentuar penale për të cilën është kanosur ta kryej dhe kur personi i arrestuar do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, gjyqtari i procedurës paraprake merr parasysh dhe urdhëron një masë më të butë nga neni 173 të këtij Kodi për të siguruar praninë e të pandehurit, e liron të pandehurin ose kërkon sqarime shtesë nga prokurori i shtetit.⁸³

Pra siç shihet nga dispozitat e KPPRK-së, roli i gjykatës është që, përpos që të verifikoj nëse ekziston realisht nevojat e sigurimit dhe nëse plotësohen kushtet për caktimin e ndonjëres nga masat e sigurimit të përcaktuar në nenin 173 të këtij kodi, ajo ka edhe rolin e mbikëqyrjes ex-officio që ti heq ato sapo të pushojnë shkaqet që i kanë shkaktuar, apo ti zëvendësoj me masa të tjera më të buta po qe se për këtë plotësohen kushtet.

4.3 Roli i Policisë në caktimin dhe zbatimin e masës së sigurimit

Zyrtari i policisë apo cilindo pjesëtar i Policisë së Kosovës apo pjesëtari i ndonjë shërbimi tjetër të autorizuar për të zhvilluar hetime penale ose për të ekzekutuar vendimin e prokurorit të shtetit apo të gjykatës i dorëzon personit ndaj të cilit është marrë masa kopjen e vendimit dhe i bën të njohur të drejtën që të zgjedhë një mbrojtës, njofton menjëherë mbrojtjen e zgjedhur nga i pandehuri ose i caktuar kryesisht dhe mban procesverbal për të gjitha veprimet e kryera.

Neni 162 shprehimisht thotë: “*Kur një person kapet në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose është në ndjekje për veprën e kryer penale, policia ose çdo person tjetër është i autorizuar ta arrestojë atë përkohësisht edhe pa urdhër të gjykatës. Personi të cilit i është hequr liria nga persona të tjerë përpos policisë,*

⁸² Shih nenin 165 paragrafi 3 i KPPRK-së

⁸³ Shih nenin 165 paragrafin 2. nën-paragrafin 2.5

menjëherë i dorëzohet policisë, e kur kjo është e pamundur menjëherë njoftohet policia ose prokurori i shtetit. Policia vepron në pajtim me nenin 163 dhe 164 të këtij Kodi”.

Policia kryen detyrimisht arrestimin e një personi që kapet në flagrancë, duke u plotësuar disa kushte të caktuara që përmendet hollësisht në këtë dispozitë.

Neni 163 tregon arsyet tjera kur policia mund të privojë personin nga liria, nëse: arrestimi lejohet sipas nenit 162 të këtij Kodi, ka urdhër të gjykatës për të arrestuar personin ka urdhër arrest që duket të jetë i vlefshëm, të pranuar përmes INTERPOL-it apo, rrugëve tjera diplomatike, arrestimi është i autorizuar nga neni 164 të këtij Kodi ose privimi nga liria është i shkurtë dhe në pajtim me nenin 72 të këtij Kodi. Çdo person i privuar nga liria me arrest sipas këtij neni duhet që pa vonesë ta sillet te gjyqtari i procedurës paraprake për të vendosur mbi paraburgimin. Vonesa nuk tejkalon dyzet e tetë (48) orë.⁸⁴

Në këtë dispozitë po ashtu na del qartë roli që ka zyrtari i policisë apo cilido pjesëtar i Policisë së Kosovës si zbatuese të masës së sigurimit. Pasi, është bërë një kërkesë nga prokurori dhe është marrë një vendim për caktimin e masës së sigurimit nga gjykata, hyn në lojë zyrtari policor, i cili realizon zbatimin e këtij vendimi duke i dorëzuar personit ndaj të cilit është marrë masa kopjen e vendimit dhe i bën të njohur të drejtën që ai ka për të pasur një mbrojtës.

⁸⁴ Shih nenin 163 të KPPRK-së

KREU V: KONKLUZIONE DHE PËRFUNDIME

5.1 Konkluzione dhe përfundime

Masat e sigurimit në teorinë juridike penale dhe në praktikën e legjislacioneve penale, vijnë si pasojë e zhvillimit dhe elaborimit progresiv liberal të së drejtës në përgjithësi dhe të drejtës procedural penale në veçanti.

Veçoria kryesore e masave të sigurimit është se ato mund të kufizojnë lirinë e personave vetëm mbi premisën e **dyshimit** për kryerjen e ndonjë veprë penale.

Në kuptimin formal-juridik dhe material-juridik, masat për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale nuk janë sanksione penale, pra nuk janë dënime por vetëm masa që zbatohen pothuaj gjatë gjithë procedurës penale dhe që e kufizojnë lirinë e personit i cili dyshohet se ka kryer një apo më shumë vepra penale. Gjatë shqiptimit të masave për sigurimin e të pandehurit, i pandehuri nuk konsiderohet i dënuar dhe se edhe më tej atij i ofrohet garancia kushtetuese e prezumimit të pafajësisë, derisa gjykata me vendim të formës së prerë të mos e dëshmojë të kundërtën.

Masa e paraburgimit është e listuar si masa e fundit për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë, mirëpo në praktikë kjo masë në të shumtën e rasteve përdoret si masa e parë dhe e vetme. Kjo masë, si masa më e rëndë për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale, thuhet se ka kaluar përmasat e një mase të sigurimit, ajo tashmë është shndërruar në një “institut juridik” nëse mund ta quajmë kështu.

Gjatë kësaj analize, kemi marrë disa shembuj që tregojnë se vonesa e kallximeve penale nga ana e policisë, ka çuar në dështimin e prokurorisë që të parashtrijë kërkesë pranë gjykatës kompetente për caktimin e ndonjërit nga masat e sigurimit. Megjithatë, nuk është evidentuar asnjë rast që tregon që polici hetues është ndëshkuar për neglizhencë. Në raste të tilla, prokurori kujdestarë duhet të iniciojë procedurë disiplinore ndaj hetuesit policorë. Në këto situata prokurori duhet të jetë më aktiv, të jetë më kërkues ndaj veprimeve hetuese-policore, të mos jetë pasiv pasi që në momenti kur është i njoftuar nga policia për ndonjë vepër penale, prokurori është personi që duhet të udhëheqë me hetimet, pra qasja e organit të ndjekjes (prokurorit) duhet të jetë qasje më proaktive.

Gjithashtu kërkohet që koordinimi në mes të prokurorit dhe policisë të jetë më i thellë. Në raste kur prokurori ka një rast të ndërlikuar me shumë të pandehure dhe me shumë dëshmitarë, kur ka filluar një hetim paraprak, ka pasur masa të fshehta, atëherë prokurori duhet të bëjë një plan të mirë me policinë në mënyrë që koha e arrestimit të të dyshuarit të jetë në favor të prokurorit, që të ketë në dispozicion kohën- orarin e punës për të proceduar me dëshmitarë dhe të ketë arsyetim të mirë kur parashtron kërkesën për caktim të masës së paraburgimit pranë gjykatës kompetente.

Në bazë të kodit të procedurës në Kosovë, nuk ka asnjë vepër penale që parasheh caktimin e masës së paraburgimit apriori, që do të thotë gjyqtarët nuk janë të lidhur ngushtësisht me peshën e veprës penale, paraburgimi obligativ parashihet veç pas shpalljes së aktgjykimit kur shqiptohet mbi pesë (5) vjet burgim, atëherë paraburgimi është i domosdoshëm deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit por jo më gjatë se sa dënimi i shqiptuar. Në këtë kuptim, gjykatat, duhet të bëjnë vlerësim të mirë të rrethanave dhe arsyetimi i masës së paraburgimit duhet të jetë i bazuar. Po ashtu gjyqtarët duhet të kenë guximin të refuzojnë kërkesat e prokurorëve për caktimin e masës së paraburgimit kur ato nuk i plotësojnë kushtet ligjore sepse çfarë do që të jetë kërkesa, gjyqtarët janë “dominus litis” kontrollues apo zotërues të procesi gjyqësor dhe të vendimeve që rrjedhin nga procedura. Në rastet e përmendura në këtë analizë, kemi hasur te rastet me interes të madhe publik, ku gjykata ka rënë në grackën e “presionit mediatic” dhe “gjykimit të publikut” duke nxjerre arsyetime siç i ka quajtur Gjykata e Apelit “për keqardhje”.

Caktimi i paraburgimit i pa arsyetuar mirë, shkakton punë të dyfishtë duke e angazhuar Gjykatën e Apelit, si gjykatë kompetente për shqyrtimin e ankesave. Në raste të tilla kur nuk ka bazë të mjaftueshme për masën e paraburgimit dhe kjo masë do të zëvendësohej me një masë tjetër me të butë, rrjedhimisht do të zvogëlonte edhe numrin e ankesave.

Për mendimin tim, nëse gjyqtarët nuk do të caktonin masa të paraburgimit tek rastet kur nuk ka elemente të mjaftueshme dhe të qarta, kjo do të shërbente edhe për disiplinimin profesional të prokurorëve sepse nëse dështojnë në një rast, rastet tjera do të jenë më të vëmendshëm dhe do të ju kushtojnë më shumë rëndësi arsyetimeve dhe bazës ligjore.

Ligjvënësit, në të ardhmen duhen të kenë parasysh që të inkorporojnë paraburgimin obligativ në procedurën penale para shpalljes së aktgjykimit, sidomos për disa vepra penale më serioze për të cilat duhet të aplikohet masa e paraburgimit në mënyrë obligative në

mënyrë që të mos krijohen baza fiktive ligjore që të mbahet i dyshuari nën masën e paraburgimit vetëm për shkak të seriozitetit të veprës penale. Për veprën penale të vrasjes së rëndë, do të ishte absurde që i pandehur të gjendej në liri.

Ndikimi i rrethanave “ekstra juridike” që burojnë nga tradita dhe zakoni, sidomos tek veprat kundër integritetit truporë kur gjyqtarët e arsyetojnë masën e paraburgimit me rrezikun e përsëritjes së veprës penale, në fakt aludojnë në hakmarrje. Gjyqtarët mundohen të gjejnë justifikime absurde vetëm për të arsyetuar masën e paraburgimit.

Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi për të ju afruar vendit ose personit të caktuar, dorëzania dhe diversioni, si masa për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë penale në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, siç shihet edhe nga statistikat janë shumë pak të zbatuara.

Është shqetësues fakti i aplikimit të shpeshtë të masës së paraburgimit në praktikë dhe lënia anash e masave tjera për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë. Gjykatat duhet të aplikojnë më shpesh masën e “dorëzanisë” dhe në vend të masës së paraburgimit, në të shumtën e rasteve të shqiptohet dorëzania si masë alternative për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë, ngase me këtë masë do të evitoheshin shpenzimet dhe do të evitoheshin gabimet për heqje të lirisë personave që në fund potencialisht mund të rezultojnë të pafajshëm. Me këtë masë edhe nëse i pandehuri do të ikte, vlera e dhënë si dorëzani ashtu siç parashihet me ligj, me aktvendim të gjykatës do të derdhej në fondin për kompensimin e viktimave dhe në një mënyrë kryesit e veprave penale do të merrnin dënimin për veprën penale të kryer.

BIBLIGRAFIA

- Sahiti, E. & Murati, R. (2016) *E drejta e Procedures Penale* / Prishtine 2016
- Sahiti, E. & Zejneli, I. (2017) *E drejta e Procedures Penale e Republikës së Maqedonisë / Shkup* 2017
- Islami, H. & Hoxha, A. & Panda, I. (2011) *Procedura Penale* / Tiranë 2011
- Hajdari, A. (2010) *Procedura Penale, Komentari* / Prishtine 2010
- Sahiti, E., Murati, R. & Elshani, Xh. (2014) *Komentari, Kodi i Procedures Penale i RKS (GIZ)*
- Hajdari, A. (2013) *E drejta e Procedures Penale, Pjesa e posaçme*/ Prishtine 2013
- Hajdari, A. (2014) *E drejta e Procedures Penale, Pjesa e përgjithshme*/ Prishtine 2014
- Sahiti, E. (2006) *Argumentimi në Procedurën Penale*/Prishtine 2006
- Kambovski, V. (2010) *E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme*/Shkup 2010
- Salihu, I. (2012) *E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme*/ Prishtinë 2012
- Raporti i Monitorimit të Gjykatave 2016 / BIRN
- Gruda, Z. (2000) *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut* /Prishtine 2000
- Islami, H., Hoxha, A. & Panda, I. (2010), *Procedura Penale*, /Tirane 2010
- Elezi, I. & Elezi, E. (2010), *Historia e së drejtës penale*, /Tiranë 2010
- Elezi, I., Kacupi, S. & Haxhia, M. (2009), *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë - pjesa e përgjithshme*, / Tiranë, 2009
- Salihu, I. (2005) *E Drejta e Penale për të Mitur*, / Universiteti i Prishtinës, 2005
- Salihu, I. (2005), *E Drejta Nderkombetare Penale*, /Prishtine 2005

LIGJET

Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedures Penale ne RKS

Ligji për procedurë penale (Gazeta zyrtare e RM nr.150/10)

Kodi Nr. 04/L-082 Kodi Penal I Republikës së Kosovës

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Kodi Penal i Republikes së Maqedonisë

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Republikes së Shqipërisë

Përmbledhje e ligjeve penale

Kodet e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë

Ligji Nr. 04/L-072 “Për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufijve Shtetëror”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.02, janar 2012 Prishtinë

Ligji NR. 04/L-213 “Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.33, shtator 2013 Prishtinë

Ligji për egzekutimin e sanksioneve penale (Gazeta zyrtare e PM nr. 2/06, 57/10).

Ligji për kundravajtje (Gazeta zyrtare e RM nr. 62/06)

Ligji për gjykatat (Gazeta zyrtare e RM nr.58/06)